



PJETËR BUDI

INSTITUTI PËR STUDIME I SHKENCËVE ORGANIZATIVE-APLIKATIVE - PRISHTINË

INSTITUTE FOR STUDIES OF THE ORGANIZATIONAL AND APPLIED SCIENCES - PRISHTINA

# STUDENTI

Vol. 2/2010



INSTITUTI PËR STUDIME I SHKENCAVE ORGANIZATIVE-APLIKATIVE - PRISHTINË

PJETËR BUDI

INSTITUTE FOR STUDIES OF THE ORGANIZATIONAL AND APPLIED SCIENCES - PRISHTINA

---

Instituti për Studime i Shkencave Organizative – Aplikative  
“PJETER BUDI” Prishtinë

STUDENTI

Nr.2/2010



INSTITUTI PËR STUDIME I SHKENCËVE ORGANIZATIVE-APLIKATIVE - PRISHTINË

**PJETËR BUDI**

INSTITUTE FOR STUDIES OF THE ORGANIZATIONAL AND APPLIED SCIENCES - PRISHTINA

---

Botues:

**Organizata Studentore “Studenti për Studentin”- Instituti për Studime  
“PJETER BUDI” Prishtinë**

Kryeredaktor  
**Emir Ukshini**

Redaksia:  
**Emir Ukshini**  
**Albert Pajaziti**  
**Donika Gashi**

Dizajni:  
**Albert Pajaziti**

Prishtinë, 2010



## PËRMBAJTJA

### Kapitulli I

#### Doganë dhe Shpedicion

Dogana e Kosovës dhe Marrëveshja e Tregtisë së Lirë -CEFTA .....	6
TIR konventa dhe TIR karneti .....	19
Ndërrmarrësia dhe menaxhemnti .....	30
Organizimi i ndërrmarrjes tregtare “mehajt” .....	40

### Kapitulli II

#### Turizëm dhe Hotelieri

Lëvizjet – zhvillimet në turizëm dhe agjencionet turistike .....	49
Muzetë dhe roli i tyre në turizëm .....	60
Vendet turistike të Kosovës.....	71



INSTITUTI PËR STUDIME I SHKENCËVE ORGANIZATIVE-APLIKATIVE - PRISHTINË

**PJETËR BUDI**

INSTITUTE FOR STUDIES OF THE ORGANIZATIONAL AND APPLIED SCIENCES - PRISHTINA

---

# **Kapitulli I**

## **Doganë dhe Shpedicion**



---

**Emir UKSHINI**

## **Dogana e Kosovës dhe Marrëveshja e Tregtisë së Lirë -CEFTA**

### **Hyrje**

Në këtë punim është paraqitur tema “Shërbimi Doganor dhe Marrëveshja e Tregtisë së Lirë -CEFTA” (Central European Free Trade Agreement), si dhe periudha kohore gjatë mbjartjes së praktikës në pikën doganore “Dheu i bardhë” e cila filloi nga data 10.08.09 deri më 14.08.09. Si burim ofruar i të dhënave janë disa libra si dhe dokumente të marra nga interneti gjatë përgaditjes së punimit.

Në vazhdim të temës kemi paraqitur themelimin e shërbimit doganor se si nisi të funksionoj dogana e Kosovës, cilat ishin pasojat në fillim të vitit 1999, pos këtyre kemi paraqitur edhe pikat kufitare që e rrethojnë Kosovën me shtetet fqinje të cilat do ti shohim në vazhdim të temës.

Kurse marrëveshja e tregtisë së lirë apo CEFTA, shtjellohen temat nënshkrimi i marrëveshjes së tregtisë së lirë me vendet fqinje, origjina e mallit dhe akumulimi i mallit. Marrëveshja e tregtisë së lirë është vetëm një shtyll, që sa më lehtë të integromi në zhvillimin ekonomik, “ *Eksperiencia botërore e ka provuar se vendet që ia mbyllën dyert tregtisë ia mbyllën dyert zhvillimit*”.

Dhe si kapitull i fundit puna praktike në doganë natyrisht se ishte një ndjenjë e veçant si për mua ashtu edhe për kolegët e mi. Gjatë kësaj kohe sa qëndrova në pikën doganore Dheu i Bardh, së bashku me mesazhin gjithçka lidhur me punën se si zhvillohet në doganat e republikës së Kosovës.

Në vazhdim do t’i paraqesim disa hapa se si zhdoganohet një DUD, në sa faza kalon. Fazat nëpër të cilat kalon një DUD janë: Evidenca paraprake, shpeditoni, pranimi, shiqimi, administrata. Në vazhdim do ti shtjellojmë se si bëhet zhdoganimi i një DUD-i.



Nuk duhet harruar edhe punën e palodhshme të të gjith kolektivit në doganë, që asniher nuk ngurruan që të na japin përgjegjje në pytjet e paraqitura nga ne. Ne si grup sa qëndruam në pikë doganore falenderojmë gjithë zyrtarët doganor të Dheut të Bardhë për përkrahjen e tyre.

Struktura e tekstit është e ndar në kapituj, pika dhe nënpika. Kryesisht kemi tre kapituj dhe disa pika të tjera gjatë shtjellimit të temës.

## **DOGANA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Nga viti 1999 e deri më tani Kosova kaloi napër shumë sfida, duke na lënë lufta me shumë pasoja vendi ynë shëndrrohet në një treg i cili kishte nevojë për çdo gjë. Ishte një situatë e jashtëzakonshme andaj edhe filloi importimi i mallrave me vëllim të madhë. Kryesisht importoheshin mallrat e konsumit të gjerë, këto mallra nuk kryeshin ndonjë procedurë doganore as nuk i përmbusheshin detyrimet doganore. Ndër gjitha këto që i përmendëm ishte edhe një e pasoj që mallrat nuk i'u nënshtroheshin kontrollimeve sanitare, veterinare dhe fitopatologjike. Kjo paraqitje rrezik shumë serioz për konsumatorët, u iponua nevojja që në Kosovë të themelohet administrata doganore, në këtë kohë kishte edhe ndërkombtar që kishin arritur, që kishin njohuri më të mëdha në këtë fushë. Prandaj, gjatë kësaj kohe e pashmangshme ishte themelimi i administratës doganore.

Gjatë hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë komisioni evropian dërgoi emisarin e vet të parë zotin Spenser Freeman, pas një kohe i erdhën në ndim edhe zonjusha Genovera Ruiz Calavera dhe zoti Richard Stone përfaqësues ndërkombtar nga Brukseli.<sup>1</sup>

### **Historiku i Shërbimit Doganor në Kosovë**

Ky shërbim është themeluar në gusht të viti 1999 nga shtylla ndërkombtare e BE-së, për t'iu përshtatur rregullave dhe dispozitave doganore për aplikimin e mallrave. Deri në

<sup>1</sup> Ylber Rraci. *Sistemi doganor në Kosovë* Prishtinë, mars 2003 fq.203-204



fund të vitit 2008 doganat ishin nën mbikqyrjen e UNMIKU-t, më 12 dhejtor 2008, u shendrua në dogan të Kosovës. Ndërsa Kodi i ri doganor u miratua më 11 nëntor 2008 nga kuvendi i Kosovës, i cili edhe mundësoi këtë tranzicion. Kodi doganor i Kosovës është në përputhje me standartet evropiane dhe ka për qëllim zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës. Dogana ka për qëllim vjeljen e taksave ku hynë: Dogana, TVSH-ja dhe Akciza.

Dogana nuk ka qëllim veq vjeljen e taksave për mbushjen e buxhtiti, por ka edhe efekt mbrojt në parandalimin e kontrabandave të ndryshme si: droga, alkooli, cigaret etj. Shërbimi doganor deri më tani ka gjithsej 591 puntorë, financohet nga buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe zhvillohet sipas standardeve të BE-s dhe përfiton shumë nga përkrahja teknike e doganës BE-s dhe nga zyra për asistencë fiskale (CAFAO), e cila ka ndimuar në zhvillimin e ligjit, strukturës, trajnimeve dhe zhvillimin dhe funksionimin e personelit. Punonjësit doganorë më shumë i përkasin nacionalitetve shqiptare ndërsa 20% prej tyre janë minoritete. Dihet se rreth 70% të të hyrave në buxhetin e konsoliduar të Kosovës vjelen nga dogana.<sup>2</sup>

## **Misioni dhe shtrirja e pikave kufitare në Kosovë**

Shërbimi Doganor i Republikës së Kosovës ka një mision të gjerë dhe ka për qëllim mbrojtjen e shtetit, mbushjen e buxhetit të konsoliduar, parandalimin e dukurive ilegale që hyjnë në shtet etj. Misioni i Doganës së Kosovës ndahet në dy grupe: të ardhurat për qështjet ekonomike dhe të ardhurat për sigurin.

Të ardhurat për çështje ekonomike përfshijnë: taksa doganore, tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH), akciza doganore, kontrrollimi i eksportit dhe importit, mbrojtja e ekonomisë kombtare.

<sup>2</sup> <http://www.dogana-ks.org/?cid=1,33>, e klikuar më 07.Gusht.2009 ora 12:00





Të ardhurat për sigurin: luftimi i aktiviteteve ilegale, shtimi i forcave të sigurisë nëpër pikat kufitare, luftimi kundër trafikimit të drogës dhe eksplozivëve të ndryshëm.<sup>3</sup>

Zakonisht në Kosovë hasim në kufi rural dhe malor, por në shumicën e rasteve kemi kufi malor. Pra, kur kemi kufi malor në sezonën e dimrit vështëron qarkullimin e mallrave, udhëtarëve etj. Deri më tani kemi 13 pikë kalime kufitare që funksionojnë, ku prej tyre 2 janë të përkohshme si Krushevë dhe Orqushë të cilat mbikqyren nga pikë kalimi i Vërmices.

Do ti përmendim me rend shtetet kufizuese të Kosovës, dhe cilat pika kaluse egzistojnë në shtetet që na përkufizojnë. Pikë kalimet kufitare mes republikës së Kosovës, me republikën e Shqipërisë janë :

- Vërmica;
- Qafa e Prushit;
- Qafa e Morinës.

Pika kaluese në mes Republikës së Kosovës me Republikën e Malit të Zi është:

- Kulla.

Pikë kalimet kufitare mes republikës së Kosovës, me republikën e Serbisë janë:

- Bërnajk;
- Jarinje;
- Merdare;
- Mutivodë;
- Dheu i Bardhë;

---

<sup>3</sup> <http://www.dogana-ks.org/?cid=1,32>, e klikuar më 08. Gusht.2009 ora 13:00



- Muçibabë.

Pikë kalimet kufitare mes republikës së Kosovës, me republikën e Maqedonisë janë:

- Hani Elezit;
- Glloboqica.

Ndërsa sa i përket kalimeve hekurudhore kemi lidhje me republikën e Maqedonisë që është Hani Elezit dhe republikën e Serbisë që është Leshaku dhe Merdare (të cilat janë jasht funksionit). Pikë kalimi i trafikut ajror është Aeroporti Ndërkombatr i Prishtinës.

Në vazhdim do ta paraqesëm një tabelë, e cila na tregon praninë e agjencive të autorizuara për menaxhimin e integruar të kufirit në pikë kalimet kufitare të republikës së Kosovës:

<b>PRANIA E AGJENCIVE TË AUTORIZUARA PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË KUFIRIT NË PIKË KALIMET KUFITARE</b>					
<b>PIKË KALIMET KUFITARE</b>	<b>POLICIA KUFITAR</b>	<b>DOGAN A E KOSOV</b>	<b>SHËRBIMI FITOSANI</b>	<b>SHËRBIMI VETERINA</b>	<b>SIPAS SHTETE</b>
Aeroporti i Prishtinës	I	I	I	I Pranishëm	Kosovë
Vërmica	I	I	I	I Pranishëm	Shqipëri
Qafa e Prushit	I	I			Shqipëri
Qafa e Morinës	I	I			Shqipëri
Kullë	I	I	I	I Pranishëm	Malin e
Bërnjak	I	I	I	I Pranishëm	
Jarinje	I	I			
Merdare	I	I	I	I Pranishëm	
Mutivodë	I				



Dheu i Bardhë	I	I	I	I Pranishëm	
Muçibabë	I	I			
Hani i Elezit	I	I	I	I Pranishëm	Maqedoni
Glloboqica	I	I			Maqedoni
Hani i Elezit	I	I	I	I Pranishëm	Maqedoni
Leshaku (Hekurudhor)					Serbi
Merdare (Hekurudhor)					

Në këtë tabelë kemi të paraqitur gjitha llojet e trafiqeve si: toksor, ajror dhe hekurudhor dhe na tregojn sakt praninë e agjencive të autorizuara për menaxhimin e integruar të kufirit në pikë kalimet kufitare.<sup>4</sup>

## MARRËVESHJA E TREGTISË SË LIRË -CEFTA

Që t'i përshtatemi ekonomisë së tregut, natyrisht se duhet të kemi raporte të mira miqësore me shtetet fqinje, posaqërisht shtetet që bëjnë pjesë në CEFTA. dhe të kemi raporte të ndërsjellta mes veti në rrugë të procesit ndërkombtar të integritimit ekonomik. UNMIKU në emër të institucioneve të përkohshme deri më tani ka arritur katër marrëveshje të tregtisë së lirë të cilat do të paraqesëm në vijim:

- Me Republikën e Shqipërisë nga data 01.10.2003;
- Me Republikën e Maqedonisë nga data 03.08.2005;
- Me Republikën e Kroacisë nga data 01.11.2006;
- Me Republikën e Bosnjës dhe Hercegovinës nga data 12.12.2006.

<sup>4</sup> Republika e Kosovës-Qeveria. *Strategjia kombëtare e republikës së Kosovës për menaxhimin e integruar të kufirit* Prishtinë, Prill 2009 fq. 16-17



Në kuadër të gjitha marveshjeve vlen të permendet, marveshja e tregtis së lirë me Shqipërinë dhe Bosnjën e Hercegovinën, të cilat janë të lira për të gjitha artikujt si ata bujqësor edhe ata industrial.<sup>5</sup>

Ministri i tregtisë dhe industrisë z.Lutfi Zharku CEFTËN e përkufizon si: “ *Është një marrëveshje e tregtisë së lirë në të cilën marrin pjesë tetë vende të rajonit të ballkanit perëndimor: Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali I Zi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Moldavia* ”.<sup>6</sup>

Marveshja e tregtisë së lirë është vetëm një shtyll, që sa më lehtë të integromi në zhvillimin ekonomik. Elemente më të rëndësishme të kësaj marveshje janë: komuniteti i energjisë, zona e përbashkët e aviacionit, transporti, telekomunikacioni etj. Të gjitha këto elemente që i përmendëm më herët, na qojn drejt një rruge të përbashkët kah tregu i madhë evropian. Të gjitha shtetet që gjenden në tregun e madhë evropian (bashkim evropian), më heret kanë qënë antrë të marveshjes së lirë CEFTA. Kur shikojm në aspektin e përgjithshëm CEFTA është një parapërgaditje drejt hyrjes në tregun e madhë evropian. Kur Kosova do të kyqet në tregun e madhë evropian ather, shteti do të mësohet me rregullat se si funksionon loja në treg me shtete të ndryshme në mënyr që integrimi evropian të përballet me sukses.

CEFTA në ditet e sotme ndihmon shumë në zhvillimin e ekonomis, të gjitha vendet kumoniste kanë kalur napër këtë proces dhe tash të gjitha kanë një liberalizim të shkëlqyeshëm të tregtisë. Ekspertët botëror than : “ *Ekspierienca botërore e ka provuar se vendet që ia mbyllën dyert tregtisë ia mbyllën dyert zhvillimit* ”<sup>7</sup>

Kemi shembuj konkret si Shqipëria në kohën e komunizmit dhe Korea e Veriut në ditët e sotme se si dështuan në mbylljen e dyreve të tregtisë.

<sup>5</sup> <http://www.dogana-ks.org/?cid=1.43> , e klikuar më 11,Gusht 2009 ora 11:00

<sup>6</sup> [Httpwww.mti-ks.org/repositorydocsnew%20cefta.pdf](http://www.mti-ks.org/repositorydocsnew%20cefta.pdf), e klikuar më 11.Gusht 2009 ora 13:00

<sup>7</sup> [Httpwww.mti-ks.org/repositorydocsnew%20cefta.pdf](http://www.mti-ks.org/repositorydocsnew%20cefta.pdf), e klikuar më 13.Gusht 2009 ora 18:00



Mënyra se si CEFTA lehtëson zhvillimin e tregtis është: harmonizimi i politikave, liberalizimi i tarifave doganore, eliminimi i barrierave jotarifore, aplikimi i rregullave të favorshme të origjinës. Një ndër fushat më të rëndësishme të marveshjes CEFTA është edhe zhvillimi i masave sanitare dhe fitosanitare që të ruajm shëndetin e njerzëve, kafshëve dhe bimëve.

CEFTA ka edhe një element të rëndësishëm si origjinën e mallit, tregtaret kosovarë nuk e rrezikojnë orisgjinën përfundimtare të prodhimit. Marim një shembull çdo lënd e parë e importuar nga vendet antare të CEFTA-s dhe e përpunuar në Kosovë produkti e merr origjinën kosovare dhe lirisht mund të eksportohet me tarif zero në cilin do vend të CEFTA-s.<sup>8</sup>

## Origjina e mallit

Kur jemi te origjina e mallit duhet të gjejmë rrugën e drejt në doganimit e një malli të importuar, duhet të dim rexhimin e tregtisë së jashtme në të cilën shtrihet ai produkt, që paraqet sakt prejardhjen e produktit. Mund të kemi produkte të njejta, por që vin nga vende të ndryshme dhe në këtë rast edhe vlera doganore mund të jetë ndryshme sepse mund të ketë tretman të ndryshme gjatë importit në vendin e caktuar.

Për prejardhjen e një produkti kemi rregullat që e përcaktojnë, ato janë: preferenciale dhe jopreferenciale.

Rregullat preferenciale origjinën e mallit e përcakton, në bazë te kontratave dhe marveshjeve ndërkombtare të ndryshme që ka lidhur me ndonjë shtet. Ku në mesin e këtyre marveshjeve mund të jenë bilaterale, multilaterale. Këto marveshje preferohen vetëm per prodhimet e vendeve kotraktuse që kanë marveshje ndërmjet veti, mund të vimë në përfundim të sakt rreth prejardhjes së produktit.

<sup>8</sup> [Httpwww.mti-ks.org/repository/docs/new%20cefta.pdf](http://www.mti-ks.org/repository/docs/new%20cefta.pdf), e klikuar më 23.Gusht 2009 ora 14:00



---

Rregullat jopreferenciale origjinën e mallit e përcaktojnë me anë të masës MFN (Most favourite nation-vendi më i favorizuar), që përmban elemente të diskriminimit gjeografik si : anti-damping, masat kompenzuese, sanksionet etj.<sup>9</sup>

Me anë të këtyre rregullave mund të përcaktohet origjina e mallit, kur e dim se një produkt prodhohet në një vend, origjina e tij është qartë. Nese marrim një shembull lëndët e para si: minerale, prodhimet pyjore, blektorale, bujqësore etj. Në këtë rast në mënyr të drejt e dimë prejardhjen e produktit.

Kur kemi një produkt që është finalizuar me impute të importuara nga një shtet tjetër, atëher origjinën e tij e përcaktojmë me anë të rregullave që i përmendëm më lart.<sup>10</sup>

## **Akumulimi**

Pasi që më herët folem rreth origjinës së mallit, është më rëndesi të dimë edhe për akumulimin. Akumulimi është një instrument i rëndësishëm i shtetit që i lejon prodhuesit vendor të importojë lëndët e para nga shtetet kontraktuse dhe i jep mundësi ti përdor ato sikur të ishin me origjinë të atijë vendi ku përpunohen.

Kemi dy forma të akumulimit ato janë bilateral dhe diagonal.

Akumulimi bilateral është më i thjesht kur kemi dy vende partnere. Për shembull Kosova impron inute (lënd të para) me origjinë të shtetit partner dhe ato i përpunon në Kosovë sikur të kishin origjinën e vendit ku përpunohen, dhe të njejta do ti ekportonë në shtetin partner pa e rrezikuar origjinën e produktit.

Akumulimi diagonal është më ndryshe se ai bilateral sepse këtu nuk kemi vetëm një shtet parter, por kur kemi shumë shtete partnere. Për shembull, Kosova kur impton inute nga një grup shtetesh partnere me origjinë të atyre shteteve, të cilat përpunohen në Kosovë

---

<sup>9</sup> Dr.Jovanka Biljanoska. *Sistemi Doganor* Manastir, 2006.fq. 154-155

<sup>10</sup> [Httpwww.mti-ks.org/repository/docs/new%20cefta.pdf](http://www.mti-ks.org/repository/docs/new%20cefta.pdf), e klikuar më 25.Gusht 2009 ora 10:00



---

dhe marin origjin të vendit ku përpunohen. Pasatj produktit final mund ta eksportojnë në cilin do nga shtetet partnere pa e rrezikuar origjinën e produktit.<sup>11</sup>

## **PRAKTIKA NË PIKËN DOGANORE DHEU I BARDHË**

Dituria që fitova në doganat e Republikaës së Kosovës posaqerisht në pikën doganore Dheu i Bardhë , natyrisht se ishte një eksperienc jashtzakonisht e madhe, si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik. Periudha kohore kur është zhvilluar puna praktike në doganë fillon prej datës 10.08.09 deri 14.08.09.

Në brendi të këtij punimi kryesisht do të ndalemi në pikat kryesore si: Evidinca hyrjes(traka), shpedicioni, pranami, shiqimi, administrata të cilat do ti shtjellojm në vazhdim.

### **Evidenca paraprake (traka)**

Këtu bëhet kalimi i automjeteve, kamionëve dhe udhëtarëve si dhe bëhet kontrollimi i tyre dhe mallrave që hyjnë në shtet. Kamionat lajmrohen në pikë hyrse mirren shenimet, dorzohen dokumentet si: faktura, çertifikata e origjines, cmr, libreza e të tjera dhe kalon landa te shpediteri.

Personi i cili e vozit automjetin ka te drejt te bart mall jo kaomercial deri në vler prej 175 euro, po në qoftë se e kalon këtë shumë atëherë duhet të paguajë doganë. Në rast se shoferi i automjetit nuk e paraqet qe ka mall per zhdoganim dhe gjat kontrollit te oficerit i gjendet ndonjë mallë që konsiderohet mallë tregtar në veturë oficeri duhet të gjobit palën.

Gjatë kalimit të kufirit shoferi apo kalimtari ka me vete para kesh mbi 10.000 euro duhet të lajmërohen dhe të plotesoj aplikacion përkatës, në të kundertën nese gjat kontrollit i zinet shuma mbi limitin e caktuar ku gjoba për këtë është 25% e shumës totale .

---

<sup>11</sup> [Httpwww.mti-ks.org/repository/docs/new%20cefta.pdf](http://www.mti-ks.org/repository/docs/new%20cefta.pdf), e klikuar më 29.Gusht 2009 ora 08:00



---

## Shpedicioni

Me origjinalin e këtyre dokumenteve si: fatura, cmr , çertifikata e origjines dhe nr. paraprak. Axhendë doganor e plotëson DTI në përputhshmëri me të dhënat që gjinden në dokumentet e lartpërmendura dhe pastaj në mënyr elektronike dhe fizike komplet DUD-in e dërgon në degën doganore përkatëse në sektorin e pranimit .

## Pranimi

Pasi të pranohet DUD-i nga oficeri i pranimit atë e korigjon dhe e harmonizon dokumentin se a ka ndonje gabim, a përputhen dokumentet dhe a ka për të ndryshuar ndonjë të dhën rreth vlersimit të mallit. Në rastet e shumta ku përher çmimi i mallit është jo në përputhshmëri me vlerat reale që gjinden në treg normalisht bëhet rivlersimi. Pasi të jetë kompletuar DUD-i në mënyr automatike duhet të dërgohet në sektorin e shiqimit.

## Shiqimi

Në këtë sektor kemi dy mënyra, mjeti transportues të del në shikim apo të del direkt në pages (administratë).

Kur mjeti transportues dërgohet në shikim (terminal), në qoftë se është nevoja edhe në skenim, ku i gjithë mjeti skenohet për ta shikuar se a është çdo gjë në rregull sa i përket mallit apo ka ndonje mall ilegal. Në këtë sektor gjat egzaminimit të mallit duhet të jenë së paku 2 oficer doganor për shkak te korrektësis së punës, mandej kjo lënd shkon në sektorin e administrates dhe lëshohet urdhërpagesa.





---

## Administrata

Ky sektor është i fundit në përmbledhjen e një Dokumenti Unik Doganor, ku në këtë sektor lëshohet urdhërpagesa për pagesen e caktuar doganore dhe bëhet për mes bankave të Kosovës pasi të përmyllet i gjith DUD-I, at'her malli është në qarkullim të lire në treg.

Kjo ishte një përmbledhje e shkurt rreth përpilimit të një DUD-i.

## Konkluzione

Kur shikojmë në aspektin e përgjithshëm kemi një përparim të madhë në fushën e doganës sepse çdo shtet që është në zhvillim e sipër ka pengesa natyrisht se edhe shteti ynë ka pasur. Nga viti 1999 e deri në ditët e sotme patëm një zhvillim jashtzakonisht të madhë sepse morëm liqencën nga agjencia angleze Crow Agents për programin softverik TIMS (Trade Information Management System). Ky program ndahet në tims lokal dhe gjendet nëpër pikat doganore dhe tims qendror që gjendet në qendër.

Marveshja e tregtisë së lirë apo CEFTA këtu mësuam rreth nënshkrimit të marveshjeve mes vendeve antare, shkëmbimit të mallrave dhe raporteve më të mira ndërmejt shteteve. Është një marrëveshje e tregtisë së lirë në të cilën marrin pjesë tetë vende të rajonit të ballkanit perëndimor: Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali I Zi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Moldavia. Në aspektin e përgjithshëm CEFTA është një parapërgaditje drejt hyrjes në tregun e madhë evropian.

Gjatë punës praktike në doganë përvetsova njohurin rreth zhdoganimit të një DUD-i, deri në procedurën e fundit dhe malli të lëshohet në qarkullim të lirë.



## Literatura

1. Jovanka Biljanoska, *Sistemi doganor*. Ohër: Mikena - Manastir, 2006
2. Ylber Rraci, *Sistemi doganor në Kosovë*. Prishtinë: Grafika Rezniciq, 2003
3. Republika e Kosovës-Qeveria, *Strategjia kombëtare e republikës së Kosovës për menaxhimin e integruar të kufirit*. Prishtinë, Prill 2009

## Burime nga interneti

1. <http://www.dogana-ks.org/?cid=1,33> , e klikuar më 07.Gusht.2009 ora 12:00
2. <http://www.dogana-ks.org/?cid=1,43> , e klikuar më 11,Gusht 2009 ora 11:00
3. [Httpëëë.mti-ks.orgrepositorydocsneë%20cefta.pdf](http://www.mti-ks.org/repositorydocsneë%20cefta.pdf), e klikuar më 11.Gusht 2009 ora 13:00
4. [Httpwww.mti-ks.orgrepositorydocsneë%20cefta.pdf](http://www.mti-ks.org/repositorydocsneë%20cefta.pdf), e klikuar më 13.Gusht 2009 ora 18:00
5. [Httpwww.mti-ks.orgrepositorydocsneë%20cefta.pdf](http://www.mti-ks.org/repositorydocsneë%20cefta.pdf), e klikuar më 23.Gusht 2009 ora 14:00
6. [Httpwww.mti-ks.orgrepositorydocsneë%20cefta.pdf](http://www.mti-ks.org/repositorydocsneë%20cefta.pdf), e klikuar më 25.Gusht 2009 ora 10:00
7. [Httpwww.mti-ks.orgrepositorydocsneë%20cefta.pdf](http://www.mti-ks.org/repositorydocsneë%20cefta.pdf), e klikuar më 29.Gusht 2009 ora 08:00
8. <http://ëëë.dogana-ks.org/?cid=1,32> , e klikuar më 08. Gusht.2009 ora 13:00



**Albert PAJAZITI**

## **TIR konventa dhe TIR karneti**

### **Hyrja**

Në fillim të këtij punimi autori ka përmendur njohurinë e përgjithshme në lidhje me Transportin Ndërkombëtare. Pastaj ka përmendur TIR Konventën, themelimin e saj, qëllimin, me çfarë kushte përdoret TIR Karneti, katër elemente themelore për përdorimin e TIR-it, kushtet me të cilat transportuesit transportojnë mallrat, përparësitë cilat rrjedhin nga TIR karneti etj.

Po ashtu është cekur çka paraqet TIR Karneti, prej sa fletëve përbehet, si funksionon, çfarë domethënie kanë tri ngjyrat e karnetit, si dhe TIR-i në ditët e sotme.

Dhe në fund, autori ka përmendur diçka më shumë rreth objektivave të TIR-it, përfitimet të cilat i ka organi doganor nga ai, si dhe transportuesit e mallrave, gjashtë principet prej të cilave është formuar TIR-i, apo në bazë të cilave funksionin TIR-i, TIR training, si dhe qasjet multilaterale të TIR-it.



## TRANSPORTI NDËRKOMBËTAR

Transporti paraqet veprimtari shoqërore që është paraqitur me dukurinë e zhvillimit të shoqërisë. Transporti paraqet veprimtari të veçantë ekonomike që ka për detyrë të bëjë mbartjen e njerëzve, mallrave, energjisë dhe të informatave nga njëri vend në vendin tjetër të hapësirës gjeografike. Nga kjo konstatojmë se njeriu që nga kohërat e hershme ka pasur nevojë për këmbimin e mallrave, shërbimeve, parave, lajmeve etj. Në këtë mënyrë, njerëzit e etniteteve, kulturave dhe religjioneve të ndryshme që kanë jetuar në kontinente të ndryshme kanë mundur shumë lehtë dhe në mënyrë të thjeshtë të këmbejnë mendime, kontakte etj.

Në këtë kontekst mund të përmendim se në OKB është formuar komisioni i veçantë për transport dhe komunikim që ka për qëllim të ndihmojë në zhvillimin dhe avancimin e raporteve ekonomike ndërmjet vendeve të ndryshme të botës.

Rëndësia ekonomike e transportit del nga funksioni kryesor i transportit që është mbartja e mallrave nga vendi i prodhimit deri tek vendi i konsumit. Mirëpo, edhe pse sot ekzistojnë lloje të ndryshme të transportit, megjithatë asnjë nga këto nuk është ideal. Çdo transport i ka vetitë pozitive dhe negative. Për këtë shkak duhet të kemi kujdes gjatë zgjedhjes së mjetit transportues, gjegjësisht cili mjet transportues në momentin e caktuar është më i përshtatshëm për transport të mallit. Çdo lloj transporti paraqet veprimtari komplekse që në vete përmban disa karakteristika me të cilat dallohet nga llojet e tjera të transportit. Këto karakteristika dalluese dalin nga mjetet transportuese që përdoren, sistemet organizative, pajisjet teknike, kushtet e eksploatimit etj.

Transporti mund të shqyrtohet nga dy aspekte: si veprimtari e pavarur dhe si veprimtari sekondare.

### **Nikollovski i paraqet këto karakteristika të transportit si veprimtari e veçantë:**

1. Veprimi hapësinor i procesit të transportit;
2. Procesi i vetëm i shërbimeve të transportit;



3. Integrimi i procesit të transportit;
4. Prezenca e obliguar e shfrytëzuesve të procesit transportues;
5. Integrim dhe unifikim i mjeteve për transport.

Esenca e transportit si veprimtari e veçantë rrjedh nga ajo se vetë transporti paraqet një formë e vazhdimit të procesit të prodhimit që mundëson mbartjen e prodhimeve deri te konsumatori. Kështu i konceptuar transporti ka ndikim të rëndësishëm në përshejtimin e rrjedhave tjera ekonomike sepse paraqitet si hallkë midis inputit (hyrjes) dhe out putit (daljes) gati në të gjitha degët e ekonomisë.<sup>12</sup>

## **TIR Konventa**

Konventa doganore për transport ndërkombëtar të mallit në bazë të TIR karnetit është nënshkruar në Gjenevë në vitin 1959 dhe është rishqyrtuar në vitin 1975. Kjo konventë duhet të mundësojë transport të mallrave me intervenime minimale gjatë kohës së udhëtimit, duke ofruar garanci maksimale për administratat doganore në të gjitha vendet transite.

Regjimi TIR është përpiluar që ti zvogëlojë vështirësitë me të cilat ballafaqohen transportuesit, dhe njëkohësisht, t'iu ofrojë organeve doganore një sistem ndërkombëtar të kontrollit i cili duke zëvendësuar procedurën tradicionale shtetërore u mundëson mbrojtje efikase të ardhurave të çdo vendi nëpër të cilat tranziton malli.

## **TIR Karneti**

TIR Karnet është një dokument doganor që thjeshton formalitetet doganore për transportin ndërkombëtar të mallrave. Mbikëqyrja dhe procedura për mjetet e transportit rrugor, kontejnerët dhe karneti TIR janë përcaktuar me “Konventën doganore mbi transportin ndërkombëtar të mallrave në baze të karnetit TIR.

Çdo TIR Karnet ka nga një numër unik referues. TIR Karneti mund të ketë 4, 6, 14, ose 20 Vauçera(kupona), ku një palë Vauçera përdoret për çdo vend ku kalohet; numri i

<sup>12</sup> Smilkovski, I, Transporti Nderkombetare, Prishtine, 2006, fq. 11



Vauçera tregon numrin e vendeve që mund të jenë të tranzituar, duke përfshirë vendet e nisjes dhe destinacioni, e, p.sh. 20-kupon Karnet mund të përdoren për një TIR nëpërmjet transportit deri në 10 vende.

Çdo TIR Karnet mund të përdoret vetëm për një TIR transport. Sapo TIR transporti është ndërprerë Doganor në zyrën e destinacionit të mallrave, shoferi është kthyer në TIR Karnet sipas rregullit e miratuar nga Autoritetet doganore e destinacionit. Autoritetet doganore duhet të konfirmojë menjëherë ndërprerjen e transportit TIR elektronike përmes SafeTIR. TIR Karnet i është kthyer e shoqërimit dhe të transportohet për në IRU përfundimtar të kontrollit dhe arkivimit.<sup>13</sup>

### ***Kushtet për përdorimin e TIR Karnetit, për bartjen e mallrave***

1. Mbartja të bëhet me mjete tokësore ose kontejner që disponojnë karakteristika të caktuara teknike që të mundësojnë kontroll më të lehtë doganor;
2. Mbartja e mallit të kryhet nëpër rrugë dhe të ekzistojë mundësia nëse paraqitet nevoja mjetet mbartëse të mund të transportohen në mjete tjera si p.sh. anije , hekurudha etj;
3. Transportuesi të ketë TIR karnet të rregullt;
4. Nga vendi i nisjes së mjeteve apo kontejnerëve të ngarkuara me mall, dogana të bëjë kontroll mbi ta, dhe TIR karnet e dhënë dhe dokumentet tjera ti pranojë si dokumente për transport ndërkombëtar.

Sa i takon sigurisë së mjeteve ose kontejnerëve kjo konventë parashikon që malli të mbartet me mjete ose kontejnerë të konstruktuar në atë mënyrë që nuk mundësojnë qasje në brendësi të tyre pasi të plumbohen nga organet doganore. Konventa përcakton normat për konstruktim dhe procedurat për miratim, përkatësisht vetëm të atyre mjeteve dhe kontejnerëve që i plotësojnë këto norma, mund të transportojnë mallin në mbrojtje të karnet TIR.

<sup>13</sup> [http://www.iru.org/index/en\\_iru\\_tir\\_TIRkarnet](http://www.iru.org/index/en_iru_tir_TIRkarnet)



## **Kushtet për transportuesit që të marrin këtë lloj miratimi të transportimit të mallrave:**

1. Të ketë hapësirë ku vendoset malli për qasje të kontrollit doganorë;
2. Destinimi i mjetit ose kontejnerit për transport ndërkombëtar me TIR karnet;
3. Në mjetin ose kontejnerin të mos ketë vende të fshehta të cilat do të përdoren për kontrabandë gjatë transportit të mallit etj. Ky miratim ose kjo leje që marrin mjetet rrugore ka afat dy vite.

Rregulla të veçanta zbatohen për mallra të rëndë të cilët nuk mund të mbarten me mjete transportuese normale.

Garancioni ndërkombëtarë i sistemit paraqet elementin e dytë themelor të transitit TIR. Funksionimi i këtij garancioni është i thjeshtë. Çdo shoqatë që i përfaqëson transportuesit, e themeluar në një vend dhe e pranuar nga organet doganore të atij vendi për garancion, i garanton në atë vend të dhënat dhe tatimet që do të kërkoheshin në rast se bëhet parregullsi gjatë kohës së transportit me regjim TIR. Kjo shoqatë nacionale garanton pagimin e tatimeve të transportuesve nacional ose të huaj për transport të kryer nën regjimin TIR e dhënë nga ajo ose nga një shoqatë në një vend tjetër. Ashtu çdo shtet, për të gjitha TIR transportimet që kryhen në territorin e saj, disponon me garanci të vendosur në atë territor. D.m.th ekziston një lloj partneri në vendin e tij, të cilit organet doganore do ti drejtoheshin në raste të parregullsive. Sistemi d.m.th mund të llogaritet si trashëgues i lëvizjeve transite nacionale të cilat më shumë bazohen në masa ndërkombëtare sesa në shtetërore përkatësisht që udhëtojnë nën mbulimin e garancionit në planin ndërkombëtar.

Në rast të parregullsive, para se ti drejtohen shoqatës garantuese, organet doganore duhet të kërkojnë pagesë nga personi që nuk i ka kryer detyrimet ndaj tyre. Çdo herë kur aktivizohet garancioni, shoqatës tek e cila është konstatuar parregullsia i drejtohen organet doganore të atij vendi dhe e cila mundëson rregullimin e punës në brendësin e shtetit. Kjo shoqatë garantuese do ta bartë këtë shpenzim me ndërmjetësim të IRU-së në



---

bazë të Pullit ndërkombëtar të siguruesit. Pasi që asnjë garancion nuk mund të jetë i pakufizuar, limitet monetare të garancisë janë të fiksuara për çdo shtet veças.

Konventa TIR e vitit 1975 parasheh afat të kufizuar të kërkesave nga ana e organeve doganore për garancinë. Prandaj është parapare që nëse organet doganore të shpaguejnë pa kushte TIR Karnetin, nuk do të mund të bëjnë reklamacione në emër të garancionit përveç nëse konstatohet se vërtetimi për shpagim është fituar me keqpërdorim ose me mashtrim. Në rast të mos shpagimit të TIR karnetit ose kur shpagimi është i kushtëzuar, shoqata garantuese duhet të njoftohet në afat prej një viti prej ditës së detyrimit të karnetit nga ana e Organeve të vendeve të interesuara. Pagimi i tatimeve dhe shtesave tjera mund të kërkohej tre muaj pas shpalljes së publikimit. Ky afat mundëson qasje në hulumtim detal dhe prezantim organeve doganore, të cilët në shume raste mund ta bëjnë pagesën të panevojshme.

Elementi i tretë dhe më i theksuar në tërësinë e sistemit TIR, përveç tabelës TIR të vendosur në automjetin është TIR Karneti i cili vet në vete përbën thelbin e sistemit TIR. Ai jepet veças për çdo automjet dhe për çdo udhëtim. I njëjti duhet ti përmbajë këto elemente:

1. Emri i dhënësit;
2. Emri dhe selia e transportuesit;
3. Dogana fillestare dhe dokumentet doganore për mjetin;
4. Leje për mjetin;
5. Vlera e mallit që është paraqitur në shkresë;
6. Vula e sekretarit të organizatës ndërkombëtare e cila e ka dhënë, respektivisht me autorizimin e të cilës TIR karnetit është dhënë;
7. Në stemën e karnet shënohet deklarata e transportuesit dhe garancionit se transporti do të kryhet sipas TIR karnetit nën përgjegjësi ligjore. Ky karnet jepet në aq fletë për sa pika kufitare do të kaloj. Karneti i bashkëngjitet edhe manifesti me aq fletë sa ka edhe vet karneti.





Elementi i katërt dhe i fundit themelor në të cilën bazohet sistemi TIR është principi në bazë të cilit masat e kontrollit doganor, të marra në vendin e nisjes duhet të pranohen nga vendet e caktuara dhe transite.

Karneti gjithashtu mund të shfrytëzohet edhe për mbartje të mallit të rëndë. Në këtë lloj transporti, në anën e parë të TIR karnetit dhe fletëve tjera shënohet „mall i rëndë”.

## **Çfarë përparësi ofron ky Karnet?**

1. Procedura doganore është e thjeshtë në kalimet kufitare dhe me këtë mjetet ndalen me shkurt në kalimet kufitare;
2. Transportuesit nuk japin garancion për mallin gjatë kalimit të kufijve;
3. Transportuesit që disponojnë me këtë karnet, nëse goditen nga sanksionet doganore, janë të mbrojtur nga konfiskimi i mjetit nga ana e organeve doganore;
4. Nëse transportuesi i thyen rregullat doganore, organet doganore regjistrojnë jo nga transportuesi por nga organizata garantuese në bazë të karnetit respektivisht nga siguruesi.<sup>14</sup>

## **TIR-i në ditët e sotme**

Në fillim të 2008 TIR Sistemit ka pasur 68 palë kontraktuese (duke përfshirë Bashkimin Europian) në katër kontinente. Shumë vende në Azi dhe në Lindjen e Mesme kanë treguar interesimin e tyre për të hyr në TIR sistem në të ardhmen e afërt.

Rritja e TIR sistemit në një mesatare vjetore prej 13% ku norma është një faktor tjetër me të cilin matet suksesi i saj. Në vitin 2007 përafërsisht 3.1 milion tabela Karnet janë lëshuar, që përfaqëson rreth 10.000 TIR transporte çdo ditë në më shumë se 55 shtete dhe më shumë se 50,000 TIR procedurat e kalimit të kufirit. 40.000 kompani të transportit janë të autorizuar nga autoritetet e tyre kombëtare për të përdorur ta TIR Karnetin.

<sup>14</sup> Smilkovski, I, Transport Ndërkombëtarë, Prishtinë, 2006, fq.89



TIR Sistemi ka dëshmuar të jetë i suksesshëm dhe i vetmi për tranzitimin e mallrave në këtë mënyrë. Ky popullaritet mund të shpjegohet me TIR regjimin, i cili ju ofron operatorëve të transportit dhe autoriteteve doganore një sistem të thjeshtë, fleksibil, kosto efektive, sistem të sigurt për transportin ndërkombëtare të mallrave përtej kufijve.<sup>15</sup>

## **TIR objektivat dhe përfitimet**

### **TIR sistemi për Doganat:**

1. Redukton kërkesat e nevojshme gjatë procedurave transitore
2. Shmanget nevojës së fuqisë punëtore të shtrenjtë, për inspektimin fizik të mallit në vendet transitore, si dhe dokumentet shoqëruese.
3. I mbron detyrimet doganore dhe taksat cilat janë të garantuara - deri në 60.000€ për TIR Transport.
4. Redukton rrezikun e dhënies së informatave të gabuara Administratës Doganore.

### **TIR sistemi për operatorët e transportit:**

1. Qarkullimin e mallit nëpër botë, pa ndonjë pengesë dhe pa ndonjë pritje në Dogana.
2. Lejon importuesve dhe eksportuesve që ta zgjedhin tipin e transportit më të përshtatshëm për nevojat e tyre.
3. Lejon përdorimin e dokumenteve bazë,
4. Lejon qasje në më shumë se 57 shtete,
5. Shmang nevojën e depozitimit të garancës për mbulimin e detyrimeve dhe taksave doganore
6. Ju lejon operatorëve të vogël dhe të mesëm të transportit, ti qasen tregut global, deri sa nuk e arrijnë pavarësinë e tyre tregtare.<sup>16</sup>

<sup>15</sup> [http://www.iru.org/index/en\\_iru\\_about\\_tir](http://www.iru.org/index/en_iru_about_tir)

<sup>16</sup> [http://www.iru.org/index/en\\_tir\\_benefit](http://www.iru.org/index/en_tir_benefit)



## **TIR sistemi përbëhet prej 6 principeve kryesore:**

1. Siguri për veturat dhe kontejnerët
2. Zinxhir ndërkombëtarë i garancës
3. TIR Karneti
4. Njohja e dyanshme e kontrollit doganor
5. Hyrje e kontrolluar
6. SafeTIR<sup>17</sup>

## **TIR Training**

1. TIR sistemi ka një mbështetje të plotë tek menaxhimi i riskut, ku element bazë i menaxhimit të riskut është TRAJNIMI.
2. Ekipi i trajnuese të IRU (International Transport Road Union), ofron shërbime të cilat janë të krijuara për avancimin e nevojshëm apo si ekspert të kësaj lëmie, në mënyrë që aktorët e përfshirë në sistemin ti kryejnë detyrat e tyre në standardet e kërkuara.
3. Ekzistojnë disa burime elektronike të cilat kontribuojnë në funksionimin më të mirë të TIR Sistemit, siç është TIR Distance Learning Package (në përpunim e sipër), si dhe trajnimi i drejtpërdrejt i cili mund të dërgohet përmes sajtit apo në adresë në Gjenevë, varësisht prej kërkesës.<sup>18</sup>

## **TIR-i në qasje multilaterale:**

1. Qasja në më shumë se 57 vende TIR përdoruesve.
2. Menaxhimi i një kosto të ulët, vlera të larta të garancës.
3. Intermodalitet.
4. Siguria në zinxhirin e furnizimit.
5. Zvogëlimin të vonesave dhe shpenzimet për bashkësinë ndërkombëtare transitin e

---

<sup>17</sup> [http://www.iru.org/index/en\\_iru\\_tir\\_key-principles](http://www.iru.org/index/en_iru_tir_key-principles)

<sup>18</sup> [http://www.iru.org/index/en\\_iru\\_tir\\_training](http://www.iru.org/index/en_iru_tir_training)



---

mallrave.

6. Lehtësim i Tregtisë: mallrat lëvizin nëpër kufijtë ndërkombëtarë me ndërhyrje minimale.
7. Inkurajimi i tregtisë ndërkombëtare
8. Përfitimet ekonomike për individët.<sup>19</sup>

## **Përfundimi**

TIR Sistemi ka dëshmuar të jetë i suksesshëm dhe i vetmi për tranzitimin e mallrave në këtë mënyre. Ky popullaritet mund të shpjegohet me TIR regjimin, i cili ju ofron operatorëve të transportit dhe autoriteteve doganore një sistem të thjeshtë, fleksibil, kosto efektive, sistem të sigurt për transportin ndërkombëtarë të mallrave përtej kufijve.

Në TIR sistemin Kosova ende nuk është anëtare e kësaj marrëveshjeje internacionale të qarkullimit të mallrave në nivel ndërkombëtarë, Anëtarësimi në këtë konvente do të jetë më shumë përparësi për Doganat si dhe për Operatoret e transportit sepse do të mundësohej procedurat më të thjeshta doganore gjatë kalimit të kufijve, vonesa e shkurt në kalimet kufitare, transportuesit nuk jepin garanc gjate kalimit te mallit nëpër kufi, transportuesit të cilët janë pjesë e këtij karneti, nëse goditen nga sanksionet doganore janë të mbrojtur nga konfiskimi i mjetit nga ana e organeve doganore, i mbron detyrimet doganore dhe taksat cilat janë të garantuara - deri në 60.000€ për Transport, redukton rrezikun e dhënies së informatave të gabuara Administratës Doganore. Pra, këto ishin vetëm disa nga përparësitë e anëtarësimit në këtë Konventë.

Mbetet që të shpresojmë që në një të ardhme të afërt Kosova do të bëhet anëtare e kësaj organizate për qarkullimin e mallrave në rrugët internacionale, si dhe anëtare e shume organizatave tjera të tilla të cilat do të ndihmojnë në zhvillimin e shtetit tonë në veçanti në lëmin e ekonomisë.

---

<sup>19</sup> [http://www.iru.org/index/en\\_iru\\_about\\_tir](http://www.iru.org/index/en_iru_about_tir)



## Literatura

1. Smilkovski, I, Transport Nderkombetare, Univerziteti Pjeter Budi, Prishtine, 2006.
2. Reckoska, G, Sistemi Doganorë, Univerziteti Pjeter Budi, Prishtinë, 2007.
3. Kekenovski, J, E drejta Doganore, Univerziteti Pjeter budi, Prishtine, 2007.

## Burime nga interneti

1. [http://www.iru.org/index/en\\_tir\\_benefit](http://www.iru.org/index/en_tir_benefit)
2. [http://www.iru.org/index/en\\_iru\\_tir\\_key-principles](http://www.iru.org/index/en_iru_tir_key-principles)
3. [http://www.iru.org/index/en\\_iru\\_tir\\_training](http://www.iru.org/index/en_iru_tir_training)
4. [http://www.iru.org/index/en\\_iru\\_about\\_tir](http://www.iru.org/index/en_iru_about_tir)
5. [http://www.iru.org/index/en\\_iru\\_tir\\_TIRkarnet](http://www.iru.org/index/en_iru_tir_TIRkarnet)
6. [http://www.iru.org/index/en\\_iru\\_about\\_tir](http://www.iru.org/index/en_iru_about_tir)



---

**Adnan HAXHOLLI dhe Urim LAHU**

## **Ndërmarrësia dhe menaxhemti**

### **Hyrje**

Me nxitjen e ndërmarrësisë, me themelimin e subjekteve të vogla dhe të mesme ekonomike ,si dhe me aplikimin e dritave bashkohore menaxheriale,krijohen parakushte për zhvillimin e ekonomisë.

Detyrë kryesore e menaxhmentit është që të siguroj sasi të mjaftueshme të prodhimeve dhe shërbimeve,dhe këtë ta bëjmë në mënyrë sa më efikase.

Dallimi ndërmjet kuptimit të ndërmarrësisë dhe kuptimit të menaxhmentit shpeshherë ka qenë object debati. Thuhet se ndërmarrësi është i lidhurë ekskluzivishtë me pronësinë dhe këtë vetëm në subjekte të vogëla dhe të mesme ekonomike.

Mund të themi se ndërmarrsi është personi i cili është i gatshëm që me rrezik të vetin,duke aplikuar ide të reja (Prodhuese, Tregtare, Menaxhuese), të ndërmerr dhe realizojnë projekte të reja ekonomike me orjentim fitimprurës. Ndërmarrësit i shfrytzojnë nmjerëzit për të fituar atë që e dëshirojn , kurse të tjerët i shohin njerzit si miq dhe të njohur me të cilët kan dëshirë të shoqrohen. Mirpo përkundr kësaj,rolet e ndërmarrsit janë të shumta: ai duhet të jetë planer,udhëheqës,novator,organizator dhe kontrollor i mire. Nëse nuk mundë t'i kryejë vetëm të gjitha këto role,ndërmarrsi i arsyeshëm do t'ia besojë disa prej tyre menaxherit.

Është vështirë që ideja e ndërmarrësit të përshkruhet dhe definohet në mënyrë njëkuptimore. Shumë prej neshë idenë për një punë të caktuarë e mbajmënë vete ajo,për



shkak të mungesës së veçorive të përmendura më sipër që janë të nevojshëm për qdo ndërmarrës, asnjherë nuk realizohet.

## NDËRMARRËSIA DHE MENAXHMENTI

Me nxitjen e ndërmarrësisë, me themelimin e subjekteve të vogla dhe të mesme ekonomike, si dhe me aplikimin e dritave bashkohore menaxheriale, krijohen parakushte për zhvillimin e ekonomisë. Në të vërtetë, menaxhmentin si disiplin shkencore dhe praktike afariste duhet ta shfrytëzojmë në të menduarit, punën dhe sjelljen e vet të gjithë ata që marrin pjesë në zhvillimin ekonomik. Pikërisht mbi bazën e kësaj mënyre të të menduarit po hapet një numër gjithnjë e më i madh i shkollavë afariste që ka për qëllim arsimimin e ndërmarrësve për disiplina të caktuara të menaxhmentit.<sup>20</sup> Nëse kësaj i shtojmë edhe kontaktin se menaxhmenti është një process në shërbim të më shumë personave për koordinimin e aktiviteteve të të tjerëve me qëllim të arritjes së rezultateve sa më të mira, me këtë do ta kuptojmë pohimin e theksuar më sipër.

Detyrë kryesore e menaxhmentit është që të siguroj sasi të mjaftueshme të prodhimeve dhe shërbimeve, dhe këtë ta bëjmë në mënyrë sa më efektive. Pa marrë para syshë se a bëhet fjalë për një kompani të vogël apo të madhe, për organe shtetërore apo organizata jofitimprurëse, rregullat e menaxhmentit janë të njëjta. Me këtë rastë menaxherët duhet t'i kordinojnë të gjitha aktivitetet me qëllim të arritjes së rezultateve, por edhe të gjejnë zgjidhjet më të mira për ndryshimet që ndodhin përreth.

Dallimi ndërmjet kuptimit të ndërmarrësisë dhe kuptimit të menaxhmentit shpeshherë ka qenë objekt debati. Thuhet se ndërmarrësi është i lidhurë ekskluzivisht me pronësinë dhe kët vetëm në subjekte të vogëla dhe të mesme ekonomike. Këto pohime janë të pasakta. Ndërmarrësi nuk mund të ndihetë nga menaxhmenti, e as që është e lidhur vetëm me një subjekt të vogël ekonomik.

<sup>20</sup> *Nga Literatura e Universitetit Pjeter Budi lenda Ndërrarësi-Ndërmarrësi dhe Menagjmenti*



## Përkufizimi kuptimor i ndërmarrësit

Mund të themi se ndërmarrsi është personi i cili është i gatshëm që me rrezik të vetin, duke aplikuar ide të reja (Prodhuese, Tregtare, Menaxhuese), të ndërmerr dhe realizojnë projekte të reja ekonomike me orjentim fitimprurës. Ndërmarrësi përgadit, zbaton dhe kontrollon projektin e vet dhe vendimet zakonisht i merr vetë. Ndërmarrsi për dallim nga pronari është inovator. Ai kërkon mënyr për zhvillimin dhe rritjen e veprimtarisë së vet dhe vazhdimisht aplikon risi.

Nga ana tjetër pronari që nuk ka afinitet dhe zotësi për ndërmarrësi, paraqet që afarizmin e vet ta mbajë në nivel aktual. Po ashtu vlen të theksohet se ndërmarrësit mund të jenë të punsuarë në një kompani të madhe dhe të mos jenë pjesëmarrës në pronësi. Fjala është për menaxherët ndërmarrës që si pundhëns, me ndihmën e novacioneve, përkatsisht të produkteve të reja, orientohen në zgjerimin e prodhimit. Dallimi ndërmjet ndërmarrsive dhe njerzve të tjerë qëndron në atë vijon: ndërmarrsive vazhdimisht fillojnë projekte të reja, kurs njerëzish e “zakonshëm” ndërmjet projekteve pushojnë. Që të ndihen të suksesshëm ndërmarrsive duhet të fillojnë shumë para: njerzish e tjerë thjesht kënaqen me vet fitimin, dhe mu kjo bënë që të ndihen të suksesshëm. Ndërmarrësit i shfrytzojnë njehzish për të fituar atë që e dëshirojnë, kurse të tjerët i shohin njerzish si miq dhe të njohur me të cilët kanë dëshirë të shoqërohen.

Ndërmarrësit më së shpeshti janë vetëpunësues dhe kanë dëshirë që kohën ta kalojnë duke menduar.<sup>21</sup> Për ta njerzish e tjerë janë tepër të ngadalshëm dhe nuk i kuptojnë, janë tepër të shkathët dhe rregullisht e realizojnë atë që e synojnë, madje edhe besimin e të tjerëve. Ndërmarrësi para së gjithash është i orientuar në realizimin e fitimit, ngase mungesa e fitimit e bënë atë të pasuksesshëm. Mirëpo, përkundër kësaj, rolet e ndërmarrësit janë të shumta: ai duhet të jetë planer, udhëheqës, novator, organizator dhe kontrollor i mirë. Nëse nuk mund të kryejë vetëm të gjitha këto role, ndërmarrsi i arsyeshëm do t’ia besojë disa prej tyre menaxherit.

<sup>21</sup> Nga Literatura e Universitetit Pjeter Budi lenda Ndërmarrësi-Ndërmarrësi dhe Menaxhmenti





Për dallim nga ndërmarrsi, menaxheri është ekspert i shkolluar i cili merr përsipër detyren dhe funksionin e qeverisjes në ndonjeren nga nivelet e kompanisë lidhur me llojin e caktuarë të aktivitetit afarist. Këta ekspert specializohen për funksionin e menaxherit (planifikimi, organizimi, udhëheqja, dhe kontrolli) ose për njerëz prej sferave të veprimtaris afariste (financat, marketing, shitja etj) edhe për dallim nga ndërmarrst, punojnë sipas urdhrit të puntorit me pag të caktuarë, për qka do të bëhet fjalë më hollsisht në kapitullin mbi menaxhmentin.

## Veçoritë e ndërmarrësit

Qdo ndërmarrës që të jet i suksesshëm duhet ti posedoj veqorit e caktuara. Ato janë të shumta dhe asnjera prej tyre veq e veq nuk kanë domethenie të madhe dhe nuk mund të kenë ndikim vendimtar në arritjen e suksesit. Mirëpo kombinimi i këtyre veqorive do të ndikojë qenësish në realizimin ose dështimin e projektit.<sup>22</sup>

Pothuajse sa here që të bëhet fjalë për veqorin e ndërmarrësit, theksohen fjalët e Peter Druckerit i cili për ndërmarrësit thotë : disa janë ekscentrikë, të tjerët konformistë – shembullor : disa janë të trashë të tjerët janë të dobët: disa janë të brengosur të tjerët janë të relaksuar: disa janë pijanecë të tjerët janë esell: disa janë njerëz plot sharmë dhe ngrohtësi të tjerët nuk kanë personalitet më shumë se sa shkëmbi i ngrirë.

Megjithatë marrë në tërësi, ndërmarrësi i suksesshëm pa marrë parasyshë sharmin dhe stilin e tij jetsorë duhet të jetë novator, i gatshëm të merr përsipër rrezikun të ketë vetbesim të jetë këmbëngulës dhe përgjegjës për realizimin e projektit të vetë.

*Veçoritë e ndërmarrësit:*

- **Novatorizmi**
- **Gatshmëria për të marrë përsipër rrezikun afarist**
- **Vetbesimi**

<sup>22</sup> Nga Literatura e Universitetit Pjeter Budi lenda Ndërmarrësi-Ndërmarrësi dhe Menaxhmenti



- 
- **Këmbëngulsia**
  - **Përshtatshmëria**
  - **Përgjegjësia e ndërmarrësit.**
  
  - **Novatorizmi** – është veqori kryesore e ndërmarrësit të suksesshëm. Ai është plot ide, i gatshëm t’i qaset projektit të pa njohurë dhe vazhdimisht të zbulojë produkte ,sherbime dhe menyra të reja të punës që i ofron në treg me qëllim të realizimit të satisfaksionit të caktuarë që nuk nënkupton vetëm fitimin. Ndërmarrësi vazhdimisht organizohet për ndryshime, reagon ndaj tyre dhe i shfrytizon ato si raste të volitshme në aktivitetin e tij afarist.<sup>23</sup>
  - **Gatshmëria për të marrë përsipër rrezikun afarist** – edhe kjo është një veqori thelbësore e ndërmarrësit. Ai e merr përsipër rrezikun afarist me qëllim të realizimit të fitimit.
  - **Vetbesimi** – ndërmarrësit i mundësohet të jetë i qëndrueshëm me përpjekjet për zbatimin e këtij projekti. Ndërmarrësit janë të gatshëm t’i zbatojnë idetë e veta pa marrë parasysh mendimin e rrethit dhe e analizave të ndryshëm. Ato janë të sigurt se mund të realizojnë atë që e kanë paramenduarë dhe nuk heqin dorë lehtë nga projektet e vet. Ndërmarrësit janë të gatshëm që pa marrë parasysh rrethanat, pengesat t’i kuptojn si sfida, e jo si probleme.
  - **Këmbëngulsia** – është e domosdoshëme për realizimin e indeë së ndërmarrësit. Pa këmbëngulësinë, shumë ndërmarrës do të heqin dorë shpejtë nga idetë e veta.
  - **Përshtatshmëria** – është një process i përhershëm i ndërmarrësit , ndërmarrësi e ka të qatrë se qka dëshirojnë të arrijnë dhe si do ta bëjnë këtë. Ata në rrugën e vet nuk kanë dyshime dhe saktësishtë e kanë të qartë se në ç’drejtim shkojnë.
  - **Përgjegjësia e ndërmarrësit** – nënkupton gatshëmërin që në qdo qast të merren merita për suksesin e ndërmarrjes, por njëkosishtë edhe faji nëse ndërmarrëja dështon.

---

<sup>23</sup> Nga Literatura e Universitetit Pjeter Budi lenda Ndërmarrësi-Ndërmarrësi dhe Menagjmenti



Disa ndërmarrës e konsiderojnë veten si “vizionarë” ngase mund të krijojnë plane të mëdha dhe invencion të guximëshëm. Ata i paramendojnë kompanitë e veta, duke u distancuar nga konkurrenca, duke definuar kategori të reja të produktëve.

## IDEJA E NDËRMARRËSIT

Se nuk mund të jeshë ndërmarrës cilësor dhe i suksesshëm dëshmon edhe fakti se shumë ide të ndërmarrësve cilësorë dështojnë. Për fat të keq, suksesin nuk e garanton vetëm ideja e mire ose fakti i ndërmarrësit por është e nevojshme edhe ideja interdisiplinare e menaxhmentit me qëllim të hartimit të një strategjie sa më të mirë të përpunohen më hollësishtë kuptimet e idesë së ndërmarrësit dhe të rastit të volitshëm, burimet e idesë dhe realizimi i saj.

## Kuptimi i idesë së ndërmarrësit

Është vështirë që ideja e ndërmarrësit të përshkruhet dhe definohet në mënyrë njëkuptimore. Shumë prej nesh idenë për një punë të caktuar mbajmë në vete. Ajo për shkak të mungesës së veçorive të përmendura më sipër që janë të nevojshëm për qdo ndërmarrës, asnjherë nuk realizohet. Nganjëherë ideja për një ndërmarrëje të caktuar lind ngadalë dhe i duhet një kohë e gjatë për të marrë formën e plotë. Mirpo, nganjëherë kjo ideshfaqet përnjëherë dhe papritur.<sup>24</sup> Asnjëherë nuk të mund ta dimë se sa do të jetë e gjatë rruga nga paraqitja e idesë e deri te realizimi i saj.

Ndërmarrësi shpeshëherë “dshurohet” në idenë e caktuar duke anashkaluar potencialin dhe mundësitë e realizimit. Kjo përmbanë dallimin ndërmjet idesë dhe rastit të volitshëm. Për të vlersuarë se a është ideja njëkohësishtë afarist duhet t’i shtrojm këto pyetje:

- A e don tregu atë që ne e ofrojmë?
- A është i gatshëm për ofertën tone?

<sup>24</sup> Nga *Literatura e Universitetit Pjeter Budi lenda Ndërmarrësi-Ndërmarrësi dhe Menaxhmenti*



- A do të na mundësohet ideja jonë kthimin e investimit Brenda afatit të knaqëshëm?
- A është ideja e jonë novacion? Cilatë elemente përmbajnë dallimin ndërmjet ofertës son dhe ofertës së konkurrencës sonë n treg?

Nëse arrijmë të jepim përgjigje adekuate në këto pyetje, do të kuptojmë se a është ideja jonë njëkohësisht edhe rast i mir. Qdo aspekt i ndonjë rasti të volitëshëm afaristë duhet të vlerësohet hollësisht, ngase tregu mundë të pësojë ndryshime atëher kur njeriu më së paku e prët.

## Shpjegimi i nocioneve “menaxhment dhe ndërmarrësi”

Menaxhmenti dhe ndërmarrësia janë ngritur në nivel të shkencave të organizimit sepse këto më tepër mësojnë për përvojat praktike me vlera të maturisë, depërtimit, për qasjen nga larg dhe racionalizimit të sjelljes për të arritur i kënaqur cakun e biznesit. Në kuptim të thjeshtë menxh (menixh) shpreh zotimin të: organizosh, mbikqyrësh, planifikosh, udhëheqësh dhe kontrollosh veprimtaritë në institucion ndërmarrje. Njësoj menagement (menixhment) nënkupton njerëzit e angazhuar në administrimin e biznesit, institucioneve publike etj. Ndermarrësia kuptohet në mjediset e gjuhës anglosaksone e cila mbështet nocionin Entrepreneurship që përbën tërësinë e Entrepreneur-it. Për nga përbërja në kuptimin e personifikimit i përgjigjet Menagerit por për dallim nga ky ka kuptim më të gjerë.<sup>25</sup>

## Menaxhmenti dhe resurset

Në zhvillimin modern pothuajse qdo veprimtari është e prirur nga menaxhmenti, ai është trunq, ai vë në lëvizje në lëvizje të përhershme biznesin. Menaxheri ose është meritore ose jo, me të identifikohet ai ose ata që qëndrojnë në timon si lider ose leadership.

<sup>25</sup> Marrur nga [www.google.com](http://www.google.com) /Menaxhmenti



---

Rregullat elementare të sëndërtimit të menaxhmentit janë: planifikimi i zhvillimit, resurseve dhe metoda e realizimit.

## **MENAXHMENTI DHE TREGU**

Në raste të shpeshta prodhuesit janë njohës të dobët të menyrës së lansimit në treg të produkteve të prodhuara. Këtu ndërhyjnë menaxheri i tregut – marketingut. Të projektosh marketingun duhet njohuri të dyanshme: për prodhim dhe mënyrën e lansimit në treg e për tregun. Veprimi i tillë sjellë deri te kërkesat e shumëfishta simetrike dhe asimetrike. Kërkesat simetrike të cilat janë pakashum të kuptueshme dhe sillen në korniza të normales. Anë pse simetrike më pak është normale shitja e Coca-Cola e cila shitet më shumë në krahasim me pijet e ngjashme freskuese të cilat janë edhe më lirë, mirëpo këtë e imponon reklamat intensive me mjete të ndryshme e të shumta.<sup>26</sup>

## **Ndërmarrësi – menaxheri**

Menaxheri është njeri dinamik me lëvizje ndërmjet iniciativës, suksesit dhe rendimentit. Përshkrimi më i shkurtër çfarë është menaxheri mund të interpretohet si njeri i talentuar i veprimit të pandërprerë deri te “aftësia e paaftësisë”. Sikur një gurrë e ujit që herë bëhet e bijshme e herë ca më e shterrur, por megjithatë rrjedhë. – ky zakonisht niset me një veprimtari. Nëse e bën të pashterrshme i përmbahet edhe më tej, kur këtë e shterrë i qaset tjetrës. Menaxheri vë në drejtëpeshim gjeturinë në hapësirë dhe kohë. Ai duhet të ketë kulturë të sjelljes dhe komunikimit. Mund të dallojmë menaxherin në rolin e statusit të : Vetmenaxherit, kryen punët vetë në biznesin e tij. Bashkëmenaxheri vepron në ekip duke kryer punët e përbashkëta me ndarjen e përgjegjësisë. Menaxheri i specializuar bënë punët sipas profilit të profesionit të tij , si prijës sektori, diler, broker etj. Edukacionin e menaxherëve dhe renditjen e tyre në vende përkatëse duhet zgjedhur me shumë kujdes.

---

<sup>26</sup> Marrur nga [www.google.com](http://www.google.com) /Menaxhmenti dhe Ndërmarrsi



---

Veçanërisht vlenë respektimi i profesionizmit, natyrës së tipareve njerëzore, dhe vlerësimi i skemave në të cilën nuk mund të frymëzohet të gjithë njësoj për çdo punë.

## **Know - How – të dish si**

Mundësitë për iniciativa të reja, duke u kufizuar për shkak se bëhen të shtrenjta ose munt të jenë të paarrishme ose të ngadalshme, që janë njësoj të paefektshme, drejtohen në aplikimin e novacioneve të “huazuara” nga të tjerët si metoda ose modele të përpunuara të emëruara si know – how (të dish si). Know-How është risi si produkt, metodë, mënyrë, program, sistem, dhe që të gjitha mund të quhen projekt know-how.kur nuk ke resurse për aplikim efektiv i shfrytëzimit të tij do të mbetet i kufizuar. Për të aplikuar duhet pasur edhe një “të dish si” .

## **Konkluzione**

- Ndërmarrësia dhe Menaxhmenti janë dy shkenca të cilat janë të lidhura ndërmjet veti dhe kanë ngjajshmeri të madhe në mes tyre.
- Ndërmarrësi sipas meje ishin krijues të cilët gjithnjë e më tepër krijojnë ide të ndryshme dhe ishte në qëdo qast dhe në qëdo kohë duke menduar se sit ë prodhonte ide për të ardhmen e tyre, dhe ishte i gatëshëm të përballonte qdo problem ,sipas tyre këto nuk i quanin problem por si sfida.
- Sipas ndërmarrësve njerzitet të tjer ishin shumë të ngadalshëm në projekte të tyre , kurse ndërmarrësit ishin ata të cilët nuk pushojshin ndërmjet projekteve të tyre.
- Menaxhmenti ishte ai i cili krynte punët mbrenda ndërmarrjes , dhe i cili u përkujdesej gjithnjë e më tepër për resurset e asaj ndërmarrje



## Literatura

- ✓ Literatura e dhënë nga universiteti Pjeter Budi në lëndën e Ndërmarrësis.
- ✓ [www.google.com](http://www.google.com) /Ndërmarrësi.
- ✓ [www.google.com](http://www.google.com) /Menaxhmenti etj.



---

**Faton SHAQIRI**

## **Organizimi i ndërmarrjes tregtare “Mehajt”**

### **Hyrja**

Në botën bashkëkohore marketingu hulumtues luan një rol shumë të rëndësishëm, duke ndihmuar ndërmarrjet në marrjen e shumë vendimeve afariste. Nga këto vendime varet shumë zhvillimi i ndërmarrjeve, mundësohet ofrimi i produkteve me çmime më të arsyeshme për konsumatorët, ofron paga më të larta dhe të llogaritura në bazë të vlerës së punës së tyre. *“Marketing koncepti kërkon që qëllim i organizatës më shumë të jetë kënaqja i konsumatorit se sa rritja e profitit”*<sup>27</sup>. Pra, në qendër të vëmendjes ndërmarrjet duhet ta kenë konsumatorin, ashtu që për çdo vendim të analizohet mendimi i konsumatorit. Kjo arrihet përmes marketingut hulumtues duke zhvilluar lloje të ndryshme të hulumtimeve varësisht prej nevojave dhe informatave në dispozicion.

Objektivi kryesor i këtij punimi është analizimi praktik i zbatimit të konceptit të marketingut nga ndërmarrjet tona. Këtë do të mundohem ta realizoj duke shfrytëzuar metodën shkencore të studimit të rastit, të ndihmuar nga metoda e analizimit të literaturës. Si rast studimi do ta marrë ndërmarrjen tregtare “Mehajt” nga Presheva.

Punimi seminarik do të organizohet në pesë pjesë. Pjesa e parë do të fillohet me një hyrje të shkurtër, duke u pasuar nga pjesa e dytë, historiku i ndërmarrjes e cila është marrë si rast studimi. Në pjesën e tretë do të analizohet mënyra e organizimit të ndërmarrjes, duke cekur strukturën organizative dhe të gjitha departamentet e kësaj ndërmarrjeje duke përfshirë aktivitetet hulumtuese të ndërmarrjes “Mehajt”. Në pjesën e katërt do të japë përfundimet e mia, duke përfunduar punimin me pjesën e pestë, respektivisht literaturën e shfrytëzuar.

---

<sup>27</sup>Prof. dr Jovan Stojanovski – Marketingu hulumtues, fq.2





## Historiku i ndërmarrjes “MEHAJT”

Ndërmarrja tregtare “Mehajt” aktivitetin e saj e fillon në vitin 1992, duke hapur një shitore në Preshevë. Në vitin 1993 është hapur shitoretja “Ideal”, po ashtu në Preshevë. Duke parë kërkesat në rritje në këtë sektor, pronarët e këtyre dy shitoreve vendosin ta bashkojnë kapitalin, duke krijuar rrjetin e shitoreve me pakicë të emërtuar “Mehajt”.

Në vitin 1994 hapen dy shitore të reja duke çuar numrin e përgjithshëm në katër. Gjithnjë duke pasur parasysh nevojën për kapitalin privat në sektorin e shitjes me pakicë, bordi drejtues merr vendim për zgjerimin e biznesit. Në këtë zgjerim përfshihet hapja e tri shitoreve të reja dhe depon qendrore ku do të mundësohet edhe shitja me shumicë. Kështu, ndërmarrja “Mehajt” në vitin 1997 regjistrohet si shoqëri ortakësh për tregtinë me shumicë dhe pakicë.

Që nga ky vit nuk ka pasur rritje të numrit të shitoreve, kjo si pasojë e luftërave të zhvilluara në trevat tona. Megjithatë, duke pasur parasysh plotësimin sa më të kënaqshëm të nevojave të konsumatorëve, ndërmarrja rregullon dhe zgjeron objektet ekzistuese

## Mënyra e organizimit në ndërmarrjen “MEHAJT”

Ndërmarrja “Mehajt” është e organizuar si rrjetë shitoresh me pakicë dhe posedon depon qendrore prej ku bëhet shpërndarja e mallit. Po ashtu, nga depoja ofrohet edhe shitja me shumicë për ndërmarrjet tjera tregtare. Për të sqaruar më mirë mënyrën e organizimit dhe punimit të ndërmarrjes “Mehajt” në vazhdim po japim strukturën organizative të saj. *“Struktura organizative paraqet një kornizë formale dhe informale të politikave dhe rregullave, brenda së cilës organizata përcakton linjat e autoritetit dhe komunikimeve, dhe përcakton të drejtat dhe obligimet”*<sup>28</sup>

<sup>28</sup> <http://www.businessdictionary.com/definition/organizational-structure.html>. data: 28 prill 2009 ora 15:00



Pasi që ndërmarrja është e regjistruar si shoqëri e ortakëve (ortakëri), bordi drejtues përbëhet nga tre ortakët të ndërmarrjes, të cilët e zgjedhin drejtorin gjeneral. Pasi që ortakëria nënkupton biznes në pronësi të dy apë më shumë pronarëve “*pjesëmarrja në pronësi paraqet bashkim të vullnetshëm të dy ose më shumë pronarëve të biznesit dhe rregullohet me marrëveshje*”<sup>29</sup>. Organizimi i punës ndahet nëpër departamente. Ashtu siç është paraqitur ne strukturën organizative, ndërmarrja ndahet në: departamentin e furnizimit, shitjes, financave e kontabilitetit, si dhe atë të hulumtimit dhe zhvillimit. Në vazhdim do të sqarojmë secilin nga këto departamente.


Shumë saktë janë të përcaktuara obligimet dhe të drejtat e punëtorëve dhe të ndërmarrjes. Ndërmarrja përveç që përkujdeset për dërgimin dhe furnizimin e rregullt të shitoreve me artikuj, ajo gjithashtu mbulon edhe:

- Prishjet e mallit,
- Afatet e skeduar të ndonjë malli,
- Ndonjë fatkeqësi që mundet të ndodhë pa fajin e shitësit.

Ndërsa obligimet e shitësit janë që të përkujdeset për të gjitha shpenzimet e operimit, të cilat përfshihen në qarkullim.

---

<sup>29</sup> Muhamet Mustafa et al. – Biznesi i vogël dhe i mesëm fq. 56





## Mënyra e organizimit në ndërmarrjen “MEHAJT”<sup>30</sup>

### Departamenti i furnizimit

Departamenti i furnizimit është njësi organizative e ndërmarrjes i cili përkujdeset për furnizimin me mallra të shitoreve dhe depos. Ky departament në bashkëpunim me departamentin e shitjes dhe të kontabilitetit përcakton politikat e ndërmarrjes për sasinë e mallrave që duhet ti mbaj në depo dhe nëpër shitore. Gjithashtu në bashkëpunim me departamentin e hulumtimit dhe zhvillimit merr parasysh kërkesat e jashtëzakonshme dhe ato sezonale. Nga bisedat me menaxherët e ndërmarrjes, mund të themi se ndërmarrja ka kërkesa të shtuara në muajt e verës, kjo për shkak se në atë periudhë vijjnë bashkatdhetarët që punojnë në vendet e jashtme. Gjithashtu porosi të jashtëzakonshme duhet të bëhen në prag të festave qoftë fetare apo kombëtare.

### Departamenti i shitjes

Departamenti i shitjes përkujdeset për shitjet që realizohen në depo dhe në gjashtë objektet tjera. Departamenti i shitjes merr parasysh të gjithë faktorët që ndikojnë në shitje, duke pasur gjithmonë parasysh katër “P”-të e marketingut: produktet, çmimet, promocioni dhe distribucioni. Në këtë drejtim, në bashkëpunim me departamentin e hulumtimit dhe zhvillimit, departamenti i shitjes përcakton politikat e formimit të çmimeve, ku ka aplikuar një strategji të çmimeve të diversifikuara, ku në dy objektet kryesore ka zgjedhur strategjinë e shitjes së sasive të mëdha me çmime më të ulëta, kurse në objektet tjera ka zgjedhur strategjinë e ofrimit të të gjitha produkteve me çmime të arsyeshme. Kjo strategji është zgjedhur pasi janë bërë hulumtime në përcaktimin e çmimeve për të gjitha objektet. Ndërmarrja me objektet e veta në pika strategjike të shitjes shërben edhe si vend promocioni për shumë prodhues dhe importues të produkteve të ndryshme. Kështu, mundë të përmendim shitjet direkte që janë bërë në objektet e kësaj ndërmarrjeje nga kompanitë e njohura si: Podravka, Aleva, Somboled etj. Por, ndërmarrja nuk ka një strategji të qartë të promocionit për veprimtarinë e vet. Edhe pse ndërmarrja ka bërë disa hapa në këtë drejtim, ata mund të klasifikohen si reagime ndaj kërkesave direkte nga konsumatorët, e jo si pjesë e një strategjie të qartë të promocionit. Nga ana tjetër, mënyra e distribuimit dhe shpërndarjes së mallit mund të konsiderohet si mjaft e qëlluar, ku ndërmarrja furnizon dy herë në javë shitoret, si dhe në bazë të nevojave edhe tri herë, posaçërisht në periudhat e verës dhe gjatë festave.

<sup>30</sup> Tabela e punuar nga autori



## Departamenti i financave dhe kontabilitetit

Ky departament mban evidentimin kontabël dhe material të të gjitha të hyrave dhe të dalave të ndërmarrjes “Mehajt”. në bashkëpunim me departamentin e shitjes, departamenti i financave dhe kontabilitetit, përcakton edhe mënyrat e pagesës së punëtorëve, ku metoda e pagesës është e përcaktuar në rrogë fikse dhe bonus në bazë të shitjeve të realizuara dhe kjo mendohet si mënyra më motivuese për punëtorët. Siç dihet departamenti i financave dhe kontabilitetit paraqitet si ofrues i informatave për menaxherët, kështu që këto informata i përpunon departamenti i hulumtimit dhe zhvillimit dhe së bashku me informatat e marra nga terreni ndihmon drejtorin gjeneral në marrjen e vendimeve strategjike.

## Departamenti i hulumtimit dhe zhvillimit

Departamenti i hulumtimit dhe zhvillimit kryesisht punon në ofrimin dhe përpunimin e informatave nga kontabiliteti dhe terreni. Në aspektin propagandues, ndërmarrja ka zhvilluar strategji të komunikimit të vazhdueshëm me klientët e vet. Në veprimtarinë e vet propaganduese, ndërmarrja përfshin publikimin e kalendarëve vjetor për blerësit e vet së bashku me mjete tjera propaganduese. Gjithashtu, është vërejtur se ndikim të madh në vendimmarrjen e konsumatorëve ka edhe reklama pranë shitoreve dhe renditja e mallrave në shitore, duke përfshirë gjetjen e lehtë të produkteve dhe katërtin në shitore. *“Kështu, ndërmarrja në çdo shitore ka nga një reklamë ndriçuese të madhe, ndërsa në dy objektet kryesore ka reklama ndriçuese me përmasa 17 metra të gjatë dhe 1 metër e gjerë dhe 10 me 1.”*<sup>31</sup>

<sup>31</sup> Nga biseda me drejtorin e ndërmarrjes “Mehajt”



## Përfundimi

Siç u pa nga shtjellimi i këtij punimi, ndërmarrja “Mehajt” ka të zhvilluar një strategji të mirë të punës së përgjithshme. Nga të gjitha sqarimet që u dhanë më herët, mund të përcaktohen përparësitë, rreziqet, mundësitë dhe dobësitë, respektivisht analizën SWOT, e cila do ta ndihmonte ndërmarrjen që në të ardhmen ti shfrytëzoj përparësitë dhe mundësitë e ti zvogëloj apo eliminoj rreziqet e dobësitë.

### Në vazhdim po japim SWOT analizën e ndërmarrjes ‘Mehajt’:

- Përparësitë
  - ✓ Pozitë të mirë strategjike të pikave shitëse
  - ✓ Njohje e mirë nga ana e distributorëve me shumicë
- Rreziqet
  - Mundësia e hyrjes në treg të konkurrentëve të rinj
  - Hapja e megamarketeve
  - Konkurrenca
- Mundësitë
  - ✓ Ofrimi i çmimeve më të volitshme në bazë të porositjeve të sasive të mëdha të mallrave
  - ✓ Shfrytëzimi i objekteve për shtije direkte nga distributorët me shumicë
- Dobësitë
  - Mos dhënia rëndësi promovimit
  - Konkurrenca



## Literatura

- (1) Prof. D-r. Jovan Stojanovski – Marketingu Hulumtues, Universiteti Pjetër Budi, Prishtinë, 2006
- (2) Msc. Evliana Berani – Ligjërata të autorizuara nga lënda Marketingu hulumtues, 2009
- (3) Muhamet Mustafa, Enver Kutllovci, Petrit Gashi, Besnik Krasniqi – Biznesi i vogël dhe i mesëm, krijimi, menaxhimi dhe rritja e biznesit, Riinvest, Prishtinë, 2006
- (4) <http://www.businessdictionary.com/definition/organizational-structure.html> ,  
Data: 28 prill 2009 ora 15:00
- (5) Të dhënat nga ndërmarrja “Mehajt” Preshevë



INSTITUTI PËR STUDIME I SHKENCËVE ORGANIZATIVE-APLIKATIVE - PRISHTINË

**PJETËR BUDI**

INSTITUTE FOR STUDIES OF THE ORGANIZATIONAL AND APPLIED SCIENCES - PRISHTINA

---

## **Kapitulli II**

### **Turizëm dhe Hotelieri**





## Vera CINA

### Lëvizjet – zhvillimet në turizëm dhe agjensioni turistik

#### Hyrje

Sot turizmit po i jepet rëndësi gjithnjë e më e madhe. Njeriu modern e përmend turizmin në jetën e tij të përditshme, shpeshherë kur flet për pushimet vjetore, për pushimet e nxënësve, të rinjëve, festave të fundvitit etj. Pra, njëfarëmenyre gjithmonë mendohet për turizëm. Turizmi është “mjet” me anë të cilit realizohen udhëtime, takime, mbledhje të ndryshme etj. Çdo njëri prej nesh ka bërë turizëm gjatë jetës së tij pasi që në kuptimin e thjeshtë të fjalës turist mund të quajmë secilin që mbi 24h është larguar nga vendbanimi i përhershëm. Normalisht se subjekt i turizmit është turisti...nuk mund të flasim për turizëm pa subjektin kryesor. Për turizmin filloi të flitej gjerësisht pas Luftës së Dytë Botërore sidomos në vendet ku punëtorët fituan të drejtën e pushimit vjetor të paguar dhe normalisht tanimë kishin kohë për turizëm pasi që edhe oraret e punës ishin shkurtuar dhe kështu u ngrit vetëdija dhe nevoja për pushim. Dikush me turizëm nënkupton vetëm pushime, por derisa për dikend mund të jetë pushim i këndshëm, për dikend mund të jetë për qëllime kurative-shëruese, për dikend udhëtim për qëllime biznesi, garave sportive, udhëtime për qëllime shfaqjesh të ndryshme etj.

Në këtë punim seminarik do të shtjelloj historikun e turizmit në përgjithësi, pra që nga koha e lashtë deri te turizmi bashëkohorë dhe e-turizmi i ditëve tona, duke përfshirë disa definicione të rëndësishme në turizëm dhe për agjensionin turistik që mendoj se kanë një lidhshmëri të madhe me njëri tjetrin.

Për ta shtjelluar këtë temë kam përdorur metoda të ndryshme të punës duke përfshirë literaturë të ndryshme nga autorë të ndryshëm, ligjërata të autorizuara, thënie, konkludime, libra universitarë përfshirë edhe kërkime të ndryshme nga interneti duke u munduar që punimi të jetë më kuptimplotë. Në këtë punim kam përfshirë edhe informatat që kam edhe nga përvoja personale e gjatë e punës në agjension turistik duke përdorur Microsoft Word dhe Power Point aplikacionet për ta prezentuar sa më mirë punimin .



## Turisti dhe Turizmi

Fjala turist dhe turizëm është përdorur në shekullin XVIII në Britaninë e Madhe. Mendohet se origjina e saj është fjalë frënge “tour” që në frëngjisht do të thotë udhëtim, me pastaj është përshtatur në gjuhën angleze dhe është ndërkombëtarizuar për tu përdorur në të gjitha gjuhët anembanë botës.

Për herë të parë termi “Turist” është përdorur më 1800 nga Samuel Pegge dhe atë në librin e tij “Tregimet qesharake të gjuhës angleze”. Pegge përdori shprehjen “udhëtari që sot e kësaj dite do të quhet turist”. Në Francë, i pari që përdori termin “Turist” ishte shkrimtari Stendhal. Librin e papublikuar më 1838 ai e emërtoi “Kujtimet e turistit”.<sup>32</sup>

Në Angli ndërkaq, për herë të parë fjala turist u përdor më 1811 dhe atë në “Magazina Sportive”.<sup>33</sup> *Përkufizimi i parë i fjalës turist është dhënë më 1876 në Fjalorin Universal të shekullit XIX (Dictionary Universale XIX)*<sup>34</sup>

## Definicionet mbi turizmin në përgjithësi

- Përkufizimi i parë është nga Littre 1889 i cili thotë: *”Turistët janë udhëtarë që vizitojnë vende të huaja për kureshtje, argëtim duke bërë udhëtim në vendet që janë vizituar më parë nga bashkëatdhetarët e tyre”*.<sup>35</sup>
- Përkufizim tjetër është ai i Guyer-Freuler që thotë *”Turizmi është dukuri e epokës tonë rrjedhojë e një nevoje në rritje për kënaqësi, pushim, zhvillim të ndjenjës të së bukurës ndaj natyrës, kontakteve mes popujve të ndryshëm, që sjell si pasojë rritje të tregtisë, të industrisë dhe përsosje të mjeteve të transportit”*.<sup>36</sup>
- Si përkufizim universal i turizmit mirret përkufizimi i Hunziker dhe Krapf në vitin 1942 dhe i njëjti përkufizim u pranua nga Shoqata e Ekspertëve Shkencorë të turizmit më 1954 dhe thotë: *”Turizmi është një tërësi raportesh dhe dukurish që rrjedhin nga udhëtimi dhe qëndrimi i vizitorëve në një vend, në qoftë se me këtë qëndrim nuk krijohet në vendbanim i përhershëm dhe në qoftë se me këtë qëndrim nuk është e lidhur ndonjë veprimtari ekonomike.”*<sup>37</sup>

1 Skriptë nga Bazat e të Drejtës së Turizmit dhe Hotelierisë- Prof.Evljana Berani

2 Po aty

3 Po aty

4 Po aty

5 Strategjia e turizmit fq.13-15 Prof.Vita Koca dhe Dr.Klodiana Gorica

6 Po aty



Në vitin 1950 Qendra Ndërkombëtare e Organizatave Turistike në kongresin e saj miratoi këto përcaktime të cilat vlejnë edhe sot:

- **Turizëm** – quhet veprimi i marrë nga ata që udhëtojnë apo vizitojnë vende me qëllim zbavitjeje, njohje apo mësimi - Organizata Botërore e Turizmit (World Tourism Organisation - shkurt WTO)<sup>38</sup>
- **Turist** –quhet gjithkush që udhëton në vende të ndryshme nga ai që është rezidenti i përhershëm pra nga ambienti i përditshëm personal, për një periudhë prej më së paku një natë por jo më shumë se një vit me kusht që qëndrimi i tij të mos jetë për përfitim ekonomik. Pra mund të përfshihen vizitat e ndryshme tek të afërmit, të vendeve të ndryshme për pushim, çlodhje, rekreacion, për qëllime fetare etj. - Shoqata e Popujve më 1937.<sup>39</sup>
- **Vizitor**-quhen të gjithë ata persona që vizitojnë një vend përveç atyre që kërkojnë punësim - Konferenca e Kombeve të Bashkuara 1963.<sup>40</sup>
- **\*Ekskursionist** - quhet vizitori i cili qëndron në vendin pritës më pak se 24 h.<sup>41</sup>

*”Turizmi i bën njerëzit të njihen, të ndajnë midis tyre vlera, tradita të cilat kanë bazë paqen dhe mirëkuptimin. Pikërisht diversiteti rrit e pasuron jetën tonë dhe turizmit i përket ky rol i rëndësishëm, jo vetëm i promovimit të respektimit të traditave të ndryshme, por duke patur si qëllim kryesor rritjen e mirëqenies së komuniteteve pritëse”.*<sup>42</sup>

## Zhvillimet-lëvizjet në turizëm

Nuk është lehtë të përcaktohet me saktësi data e lëvizjeve turistike ose thënë më qartë data e fillimit të turizmit. Historia na ka treguar se udhëtimet janë të vjetra sa edhe vetë njerëzimi. Njerëzit gjithmonë udhëtuan për jetë më të mirë, duke kërkuar kushte më të mira, ushqim, strehim etj. Më vonë udhëtuan për qëllime historike, qëllime krijuese, ushtarake, pra të ngjajshme me udhëtimet e sotme. *”Udhëto që të gjesh urtësinë”*, ky përcaktim ekzistonte të popujt e lashtë dhe besoj që më së miri e përkufizon rëndësinë dhe domethënien e turizmit sidomos në atë kohë. Në kohën e Egjiptit, Babilonisë dhe Persisë bëheshin udhëtime masive me rastin e ceremonive të ndryshme fetare si p.sh. për

<sup>38</sup> Wikipedia-turizmi

<sup>39</sup> Po aty

<sup>40</sup> Po aty

<sup>41</sup> Po aty

<sup>42</sup> UNWTO - thënie e Ban Ki Moon



t'ju lutur zotit Apis. Po ashtu në Babiloni, Kinë dhe Indi populli e njihte dhe e dinte rëndësinë e ujërave termale që gjithashtu ishte shkak i vizitave të shumta . Pastaj në Greqi asokohe ekzistonin tri vende të cilat frekuentoheshin në mënyre masive si Delfi, Olimpi dhe Delos. Në vendin e parë udhëtohej për qëllime fetare, në të dytin për qëllime fetare dhe sportive e në të tretin vizitat ishin ekskluzivisht qëllime argëtimi dhe pushimi.

Grekët i kanë njohur edhe disa veçori “shëruese“ të ujërave minerale ndër të cilat më të njohurat ishin Banja e Heraklieas dhe burimet termale të Termopileve. Romakët poashtu i jepnin rëndësi të veçantë udhëtimit dhe kanë udhëtuar shumë. Ata kishin kushte më të mira pasiqë edhe territori i tyre ishte i ndërtuar prej rrjetit rrugor prej 90.000 km, kishin banja të ndryshme termale dhe organizonin shumë shfaqje. Ata përkudesheshin shumë për gjendjen e mirë fizike dhe ndërtonin afër vetes qendra termale, ndërtonin villa për sundimtarët etj. Argëtimi i tyre fillimisht ishin shfaqjet, pastaj filluan edhe me cirk prej nga edhe rrjedh fjala cirk nga “circinzes”, më vonë filluan lojëra të kombinuara me atletikë dhe me luftëra të gladiatorëve që ishin johumane dhe mjaftë tronditëse. Në këtë kohë shquhej arena Koloseum ku mund të hynin 80.000 persona.

Si në Greqinë e lashtë ashtu edhe në Romë kishte mikpritje dhe respekt ndaj vizitorëve dhe zbatoheshin disa rregulla që zbatohen edhe sot si p.sh. përkujdesja në lidhje me bagazhin, garancionin e hotelit etj.

Në mesjetë udhëtimet stagnuan dhe humbën kuptimin që e kishin në lashtësi sepse asokohe ndikimi i kishës tek njerëzit ishte i madh. Në këtë kohë shquhen udhëtimet për qëllime religjioze ku vlen të përmendet qyteti spanjoll Santiago de Kempestela që vizitohej masovikisht në shekullin XI dhe XII. Roma dhe Jerusalem u bënë qendra vizite për popullsinë e krishterë, Meka dhe Medina për popullsinë myslimane, Lasa në Tibet për budistët etj. Në këtë kohë poashtu banjat dhe burimet termale shfrytëzoheshin si rezultat i konceptit higjienik të predikuar nga kisha.

Më i ngjajshëm me turistin e sotëm është udhëtari i kohës së humanizmit dhe renesansës i cili udhëtonte nëpër Europë për motive kulturorë- shkencore, për zbulime apo zhvillim në lëminë mjeksisë apo farmacisë. Në këtë kohë e hasim edhe fjalën “ grand tour “ që përkufizonte udhëtimet nëpër Europë, nëpër qendrat e mëdha kulturore. Këto udhëtime ishin më të gjata dhe më shumë kishin karakter zbulues shkencor.

Klasa borgjeze fillon edhe me udhëtime për qëllime argëtuese dhe rekreative, por udhëtimet marrin hov me rastin e zbulimit të makinës me avull, pastaj hekurudhës, rrugëve, anijeve, dhe kulminacioni vjen me zbulimin e makinave – veturave e në fund edhe aeroplanit në vitet ‘60 dhe ‘70.

Pasiqë u zbulua makina me avull që lëvizte me shpejtësi prej 22km/h ( konstruktuar nga Stivensoni më 1814), hekurudha e parë filloi me punë në vitin 1825 në Britaninë e Madhe duke bërë transportin e parë hekurudhor midis Liverpulit dhe Manchesterit. Mund të thuhet se këto janë fillet e para të turizmit - transportit, por jo në mënyrë të organizuar, që më vonë filluan edhe në Zvicër dhe Gjermani.

Pra, ka pasur lëvizje të ndryshme në turizëm prej kohës së lashtë deri në ditët e sotme duke kaluar nëpër fazë të ndryshme të zhvillimit të ndikuara nga faktorë e ndryshëm të zhvillimit të përgjithshëm global. Pra, kemi zhvillimin e turizmit nga turizmi i



paorganizuar apo i “egër” deri tek e-turizmi sot, ku mund të veçojmë dy periudha të rëndësishme të zhvillimit të turizmit:

1. “Epoka- periudha e turizmit të klasave të privileguara” deri në gjysmën e dytë të shekullit të XIX<sup>43</sup> dhe

2. “Epoka- periudha e Turizmit Bashkëkohor Modern” që fillon në pjesën e dytë të shekullit të XIX dhe zgjatë deri në ditët tona.<sup>44</sup>

## Organizimi i parë

Udhëtimi i parë i organizuar u realizua nga Tomas Kuk ( Thomas Cook 1808-1892) në vitin 1841 në Britani. Ai ishte sekretar i shoqatës kundër alkoolit dhe arriti të formojë një grup prej 570 pasagjerëve duke bërë një udhëtim argëtues njëditor me tren ndërmjet dy qyteteve në Britani (Leicester-Liverpool) . Ky udhëtim zë vendin e parë në udhëtimet e organizuara në turizëm. Pastaj Kuk më 1845 organizoi udhëtimin e dytë këtë radhë duke kombinuar transportin hekurudhor me atë detar për në Irlandë dhe po këtë vit formoi agjensionin e parë turistik “Kuk dhe i biri”(Cook and Son) që konsiderohet agjensioni i parë i mirëfilltë asokohe. Fillimisht punuan vetëm dy persona e më pas u zgjëruan me një shpejtësi të madhe dhe filluan të hapeshin edhe përfaqësitë apo edhe agjensionet e tjera në shumë vende të botës. Në vitin 1851 u organizua udhëtimi për Ekspozitën Botërore në Londër që kishte rreth 165.000 vizitorë , pastaj u organizua vizita e ekspozitës në Paris më 1867, ndërkaq udhëtimi i parë turistik për në Amerikë u organizua më 1860 që i parapriu edhe udhëtimin të parë nëpër botë më 1871.

Kuk ishte model për të tjerët dhe kështu filluan edhe organizime të tjera gjithandej nëpër botë , filloi të aplikohet bileta e udhëtimin, voucher-i, ose edhe traveler-check-u. (që edhe sot e kësaj dite e mban emrin e Thomas Cook-ut) . Edhe sot e kësaj dite ekziston agjensioni apo thënë më mirë korporata ( Thomas Cook Worldwide) që tani mirret me shumë veprimtari të ndryshme të turizmit . Në anën tjetër filloi ngritja e objekteve të mëdha që tanimë quheshin hotele ku si më të vjetrat njihen “ Grand Hotel “ dhe “Grand Hotel du Luvër “ në Paris,“ Kajzer hotel “ në Berlin etj.<sup>45</sup>

## Agjencionet turistike

Shembullin e agjencionit të parë turistik e ndoqën edhe shumë agjensione tjera p.sh. në New York kompania “American Express“ filloi të punojë edhe si agjensitë turistike. Si

<sup>43</sup> Liggjërata e autorizuar-Prof Ardian Emini fq.1-2

<sup>44</sup> Liggjërata e autorizuar-Prof Ardian Emini fq.1-2

<sup>45</sup> Teoria generale del turismo. A.Fragola fq.19




agjension i parë turistik në Republikën e Kroacisë konsiderohet agjensioni i vëllezërve Mihanovic që organizuan udhëtime paushalle me tren për në Gradac dhe Vienë në vitin 1863. Gjatë kohës së Jugosllavisë shquhej agjensioni “Putnik” që kishte përfaqësi të shumta në vend dhe jashtë vendit përfshirë edhe Kosovën. Më vonë si agjension i specializuar për aranzhmane të ndryshme nëpër bote ishte “Air Lift” që lindi dhe u zhvillua në kuadër të aviokompanisë ajrore “JAT”. Në vendin tonë shquhej agjension i mirëfilltë “Turist Kosova” që ishte në kuadër të Lidhjes Turistike të Kosovës. Në dekadat e fundit të shekullit të kaluar u hapën shumë agjensione turistike gjithandëj nëpër botë që mirreshin me degë të ndryshme të turizmit.

Puna me agjensionin turistik edhe tek ne shihej si një mënyrë e mirë e punës dhe përfitimit duke u nisur nga fakti i numrit të madh të njerëzve tanë në diasporë dhe duke u orientuar plotësisht në aranzhimin e udhëtimit të organizuar apo shitjen e biletave për destinacione të caktuara. Pra, kishim të bëjmë vetëm me transportin e udhëtarëve dhe mallërave. Asokohe edhe puna e agjensioneve turistike sikurse edhe çdo punë tjetër ka qenë më e vështirë dhe më e komplikuar ndërsa tani duke pasur mundësinë e përdorimit të teknologjisë agjensionet turistike posedojnë sisteme të ndryshme që mundësojnë ofrimin shërbimeve për rezervime të aviobiletave apo hoteleve, rent a car etj. Ndër sistemet globale më të njohura janë : Amadeus, Sebra, Galileo, Worldspan, Go Global etj. pa të cilat nuk mund të paramendohet funksionimi i agjensionit të mirëfilltë. Kryesisht këto sisteme të rezervimeve janë pikërisht ajo ura lidhëse apo ndërmjetësimi në mes agjensionit - hotelit, aviokompanisë, transferit, trenit, etj. Ende skemi ndonjë përkufizim të veçantë apo specifik për agjensionin turistik por mund të themi se një agjension turistik është një ndërmarrje e vogël ose e mesme që si biznes ka ofrimin e të gjitha shërbimeve që kanë të bëjnë me turizmin p.sh. këshillime të ndryshme për klientë-turistë, aranzhimin e udhëtimit me linjat ajrore (fluturimet me aeroplan), tokësore (autobuse, vetura “rent a car”), linja detare (anije, trajekte, “rent a boat”), linja hekurudhore (trena të ndryshëm), ndonjë organizim koncerti apo manifestimi brenda ose jashtë shtetit, organizim të takimeve apo konferencave, akomodim në hotele apo përgaditja e aranzhmanit të plotë turistik. Duhet pasur parasysh se aranzhman quajmë kombinimin e paku dy shërbime të lartpërmendura p.sh transport + hotel etj. Veprimtaria e agjensioneve turistike zhvillohet në kuadrin e tregut turistik të cilat ofrojnë shërbime turistike. Përmes shërbimeve që ofrojnë agjensionet turistike bëjnë ndërmjetësimin midis kërkesës dhe ofertës turistike. Agjensionet konsiderohen si faktori më i rëndësishëm ndërmjetësues në turizëm. Këtu nuk mund të mos e përmendim “Tour operatorin”, që si funksion kryesor ka organizimin e plotë derisa agjensioni turistik ka të bëjë kryesisht me ndërmjetësimin. Tour operatori sjell në treg ofertat e tija apo edhe të ndonjë korporate që e përfaqëson në mënyrë që ajo të ju servohet klientëve përmes agjensioneve turistike.





## Skema e shitjes së produktit turistik





## Roli i agjensioneve turistike

Mund të themi se rolet themelore të agjencionit turistik janë:

- **Roli i ndërmjetësimit**

Nga vetë fjala ndërmjetësim nënkuptojmë këtë rol të rëndësishëm apo themelor të agjencionit turistik. Thjesht do të shpjegohej si urë lidhëse në mes të klientit dhe tour operatorit apo ofruesit të drejtpërdrejtë. Në këtë rast agjensioni nuk ofron ofertën e vetë drejtpërdrejtë por ofron shërbimin duke bërë lidhjen apo ndërmjetësimin në mes të klientit dhe aviokompanisë, apo klientit dhe hotelit etj.

- **Roli i këshillimit**

Ky rol mund të llogaritet si funksioni më i vjetër i agjencionit turistik. Agjensionet turistike kanë njohuri të mirë mbi ofertat e ndryshme në treg dhe duke qenë në kontakt me klientët ata japin sqarime dhe udhëzojnë në mënyrë që klienti të ketë informata të sakta dhe të bëjë zgjedhje që ai konsideron më të mirë. Në anën tjetër ka edhe shumë klientë - turistë të pavendosur, që kërkojnë mendimin apo ndihmën profesionale nga agjensioni turistik duke kërkuar sygjerime për oferta të reja apo informata për vende apo shtete të ndryshme. Komunikimi- këshillimi zakonisht bëhet me bisedë të drejtpërdrejtë apo edhe përmes telefonit dhe postës elektronike duke i bashkangjitur edhe ndonjë broshurë, katalog etj.

- **Roli promotiv**

Duhet të themi se ky rol hyn në aktivitete të marketingut pasi që agjensioni mund të distribuojë më së miri dhe në vendin e duhur materialet promovuese të tour operatorëve, apo ofertuesëve të ndryshëm. Agjensionet turistike zakonisht posedojnë broshura të ndryshme, katalogje, inçizime apo edhe fotografi të vizitave të ndryshme personale. Këtu do të veçoja edhe rolin e duhur të të ashtuquajturave “fam trips” që aviokompanitë dhe tour operatorët apo hotelet i organizojnë për ta njoftuar sa më afër stafin e agjensioneve turistike mbi ofertat dhe produktet e tyre dhe në këtë mënyrë përvoja nga vizitita personale e agentit turistik do të jetë këshilla më e mirë për klientin.





- **Roli ose funksioni organizativ**

Tani këtu agjensionin e gjejmë vet në punë me klientin pa palën e tretë, tour operatorin, për dallim prej rolit ndërmjetësues. Këtë e vleresoj si rol të domosdoshëm dhe shumë të rëndësishëm dhe kreativ. E quaj kreativ sepse për ta përmbushur kërkesën e klientit, për ta bërë organizimin e një “paket aranzhmani vetanak” duhet qenë shumë kreativ. Ka klient i cili ka në dispozicion katër ditë të lira dhe s’di se si t’i kalojë. Tani këtu kemi të bëjmë me një organizim që duhet të jetë komplet duke përfshirë itinerarin e plotë, organizimin e udhëtimit, transferit, akomodimin në hoteli, vizitat e ndryshme me qëllim kulturor, historik apo rekreativ etj.

## **E-Turizmi**

Interneti ka ndryshuar në mënyrë drastike ndërmjetësimet në udhëtime dhe mund të themi se industria e turizmit po hyn gradualisht në erën e e-turizmit. E-turizmi ofron mjete dhe mekanizma për komunikim direkt me klientët. Klientët kanë mundësinë të marrin 24 orë gjatë 365 ditëve informacione të ndryshme. Shumë agjensione, tour operatorë, kanë “nuhatur” rrezikun dhe kanë ofruar shërbimet e tyre “online”. Në këtë mënyrë është bërë ofërta më e begatshme, më atraktive, më transparente dhe më e sofistikuar.

OBT-thotë: *”Çelësi i suksesit është identifikimi i nevojave të konsumatorëve dhe arritja e klientëve potencial me një informacion të kuptueshëm të personalizuar dhe të rinovuar”*<sup>46</sup>

Për agjensionin turistik ka shumë thënie si:

*“Agency that arranges personal travel”* agjensioni që përkujdeset për udhëtimet e mija personale e hasim shumë shpesh sidomos te klientët “besnik” që zakonisht edhe janë mënyra më e mirë e marketingut për agjensionin turistik.

*“Service, saving, solution”* pra shërbim, kursim, zgjidhje apo solucion. Kjo kjo duke u nisur nga ajo se me anë të shërbimit të agjensionit turistik kursethet në kohë që mund të quhet edhe “luks” i kohës moderne, kursethet në mjete dhe ofrohen zgjidhje për kërkesa të ndryshme.

---

<sup>46</sup> Strategjia e turizmit fq. 414 Dr.Klodiana Gorica dhe Ma.Fioralba Vela



## Konkluzione

Nga përvoja në turizëm dhe duke shfletuar literaturë të ndryshme mbi turizmin, duke e parë turizmin si industri, si degë të rëndësishme të ekonomisë, si faktor të rëndësishëm të afirmimit të shtetit mendoj se është shumë e rëndësishme që të zhvillohet turizmi i mirëfilltë në shtetin tonë. Këtu kam parasysh edhe zhvillimin e sektorëve të tjerë që mund t'i quajmë “furnizues të turizmit” dhe kam parasysh potencialin njerëzor, bukurinë dhe pasurinë natyrore që ka vendi ynë.

Mendoj se interesante është edhe gjuha, trashëgimia kulturore, tradita, folklori, artizanatet që do të bënin prezentimin më të mirë të mundshëm të një shteti të ri. Vendi ynë do të ishte shumë atraktiv për turistët pasi që historikisht turistët nga vendet e zhvilluara shohin si atraksion turistik vendet në zhvillim ose edhe më pak të zhvilluara që për vite të tëra ishin të mbyllura. Tanimë bota do të shihte se ne nuk jemi dhe nuk është Kosova ashtu siq është prezentuar gjatë okupimit. Rol të rëndësishëm këtu në aspektin e investimeve në turizëm duhet të luajë shteti por edhe partnerët privat. Pajtohem dhe them se një pjesë të barrës apo përgjegjësisë duhet bartur edhe agjensionet turistike duke promovuar sa më shumë dhe sa më mirë ofertën turistike vendore.

Edhe pse mendohej nga shumica se me përsosshmërinë e teknologjisë dhe internetit (e-bookings, e-vouchers, e-hotels), roli i agjensionit turistik do të zvogëlohet, duke u bazuar në rolet dhe funksionet e agjensionit turistik veçanërisht agentit-këshilltarit turistik, mendoj se kjo nuk qëndron gjithnjë duke u bazuar në faktin se besueshmëria është më e madhe në komunikim të drejtpërdrejt dhe këshillimet dhe shërbimet profesionale janë treguar si mënyra më e mirë e ofertimit. Duhet pasur kujdes që gjithnjë dhe në çdo hap të ecim me kohën dhe të bëjmë ofertat në varësi prej kërkesës dhe në pajtueshmëri me trendet aktuale. Prandaj mendoj se roli i agjensionit turistik është dhe do të mbetet mjaft i madh si në organizim apo ndërmjetësim.



## Literatura

1. Vita. K- Klodiana. G. “ *Bazat e Turizmit*”
2. Emini.A.”Ligjëratë e autorizuar nga lënda Bazat e Turizmit”.Prishtinë 2009.
3. Berani.E.” Ligjëratë e autorizuar nga lënda Bazat e së Drejtës dhe e Drejta në Turizëm dhe Hoteleri “,Prishtinë 2009.
4. Gorica.K – Vela.F. “*Strategjia e Turizmit* “
5. [www.wikipedia.org/turizmi](http://www.wikipedia.org/turizmi)
6. [www.unwto.org](http://www.unwto.org)
7. Revista të ndryshme mbi turizmin dhe agjensionin turistik.



## Asije AZEMI

### Muzetë dhe roli i tyre në turizëm

#### Hyrje

Shkaku që fillova të punoj këtë temë si punim seminarik është pikërisht rëndësia dhe roli që kanë muzetë në ruajtjen dhe paraqtjen fillimisht të asaj se qfarë kemi qenë më parë, por gjithashtu edhe në vazhdim atë qka jemi. Muzetë janë të ndryshme në varësi të përmbajtjes së objekteve të ekspozuara, ato mund janë muzë historike, artistike, galeri, muze të natyrës, teknologjisë, etj. andaj shoh të nevojshme njw zgjerim nw lidhje me këto muze.

Muzetë janë kryesisht janë të dedikuara për publikun e gjerë dhe shumica sosh datojnë që nga shek XXIII-të mirëpo objektet ose objektet e ndryshme janë të periudhave të ndryshme duke filluar nga parahistoria, kjo gjithashtu është njëra ndër qështjet e shtjelluara në punim seminarik.

Në këtë punim gjithashtu do mundohem ta paraqes me disa shembj rolin dhe rëndësinë që kanë muzetë në zhvillimin e turizmit në përgjithësi në ekonomi, në edukim e kulturë në veçanti. Për gjetjen e të dhënave kam shfrytëzuar burimet në internet , gjithashu edhe njohuritë e mija për temën e shtjelluar.

## Muzetë - institucionet kulturore

Një muze është një ndërtesë apo institucion që strehon një koleksion të objekteve.<sup>47</sup>. Sipas ligjit për Mbrojtjen e Trashëgëmisë Kulutore të Kosovës muzetë janë institucione kompetente për menaxhimin e koleksioneve publike të trashëgimisë së luajtshme. Muzetë mbledhin dhe kujdesen për objektet me rëndësi shkencore, artistike, ose historike duke qenë në dispozicion për publikun, përmes ekspozitave të ndryshme të cilat mund të jenë të përhershme apo të përkohshme. Shumica e muzeve të mëdha janë të vendosura në qytetet e mëdha në të gjithë botën dhe muzetë më të vogla ekzistojnë në qytetet më të vogla, qyteza dhe madje edhe në fshatra. Mendohet se fillimisht muzetë filluan si koleksione private të njerëzve të pasur, familjeve ose intitucioneve të artit, si objekte të rralla natyrore etj. Muzetë e para publike në botë u hapën në shek. e XVIII-të. Kulla e Londrës 1966,(fig.1)



fig.1

Muzeu i Arteve të Bukura dhe Arkeologjisë në Besançon 1694,(fig.2)



fig.2

Muzeu Sacro i Vatikanit 1759,(fig.3)

---

<sup>47</sup> Edward Porter Alexander



fig.3

Galeria Uffizi në Firence 1765,(fig.3)



fig.3

Pallati Bevedrere i Mbretërisë së Habsburgëve në Vjenë 1781 (fig.4) etj.



fig.4

Edhe pse ishin muze publike prapsepapë ishin të kapshme vetëm për klasat e mesme dhe të larta të shoqërisë. Vendodhjet e muzeve janë të ndryshme në varësi të ngjarjeve ose hapsirës ku ato janë vendosur. Ato mund të jenë në fshatra ose në qytete më të mëdha , e sigurisht që edhe madhësia e tyre është në proporcion me madhësinë e vendndodhjes. Muzetë mund të shfaqin programe dhe aktivitete të ndryshme për dëshirën e publikut, pa marrë parasysh moshën ose gjininë. Lloji ose forma e këtyre programeve mund të jenë argëtuese, ose me qëllim edukues, si mësim nga fakultetet e ndryshme për muzetë, filma, shfaqje artistike, ose në kohën bashkëkohore paraqitje të teknologjisë së re. Disa prej tyre mund të jenë të prekshme për publikun , ndërsa shumica prej tyre nuk lejojnë





kontakt të drejtpërdrejtë me objektet në muze, ndërsa me futjen e internetin po bëhen gjithnjë e më të përdorura ekspozitat virtuale.

Muzetë mund të jenë në pronësi të publikut që shpesh janë pa pagesë, por edhe shpesh herë ato kanë qëllim për të fituar, ndërsa përjashtim bëjnë galeritë ku për fitim bëjnë shitjen e objekteve të ndryshme qofshin ato artistike, teknologjike, artizanale etj. Muzetë mund të themi se janë përfaqësuesit më të denjë të kulturës dhe historisë së një populli. me ruajtjen e objekteve dhe me koleksionimin e tyre bëhet ruajtja dhe paraqitja e kulturës paraardhëse të popujve dhe vendeve të ndryshme. *“Muzetë janë institucione të përhershme në shërbim të shoqërisë dhe zhvillimit të saj, të hapura për publikun, të cilat mbledhin, ruajnë, hulumtojnë, komunikojnë dhe ekspozojnë trashëgiminë konkrete dhe jomateriale të njerëzimit dhe mjedisit të tij, për qëllim të arsimit, studimit dhe kënaqësisë.”*<sup>48</sup>

## Llojet e muzeve

Muzetë për nga përmbajtja dhe qëllimi i tyre ndahen në disa sosh, ku në vende ose qytete më të mëdha ato janë më të mëdha, ndërsa në vende më të vogla janë muze më të vogla. gjithashtu edhe temat e tyre janë të ndryshme: muze për arte të bukura, artizanale, arkeologji, antropologji dhe etnologji, pastaj muzetë historike me përmbajtje ushtarake, kulturore, natyrore, muzetë e shkencës, teknologjisë, muzetë e fëmijëve, muzetë numizmatike, botanike dhe kopshte zoologjike. Si pjesë përbërëse të këtyre llojeve të muzeve kategorizohen më tutje edhe muzetë e artit modern, historisë lokale, historisë së aviacionit, bujqësisë, gjeologjisë etj. Objektet e muzeve duhet të regjistrohen zyrtarisht për mbledhjen e objekteve dhe të dhënat për origjinën e tyre. Personat të cilët mbledhin dhe ekspozojnë objekte ose të dhëna quhen kuratorë.

**Muzetë arkeologjike** - Janë ato muze të cilat shfaqin ose ekspozojnë objekte arkeologjike. Këto muze mund të jenë edhe të hapura, si psh. Akropoli i Athinës (fig.5)



Fig.5

<sup>48</sup> Këshilli ndërkombëtar i Muzeve -<http://en.wikipedia.org/wiki/Museum>



---

Ndërsa në vendet tjera objektet arkeologjike gjinden brenda ndërtesave.

**Muzetë e artit** - Muzetë e artit njihen ndryshe edhe si galeri arti, në këto hapësira ekspozohen zakonisht objekte arti si arte pamore, kryesisht piktura, ilustrime dhe skulptura. Koleksionet e vizatimeeve dhe formave tjera të vjetra nuk shfaqen shpesh në mure ato ruhen në dhoma të shtypjes. Këto koleksione të artit të aplikuar përfshijnë gjithashtu edhe qeramikat, punën e metaleve, mobiljet, librat e artistëve dhe lloje të tjera të objekteve.

Muzeu i parë publik në Europë ishte Kabineti-Amerbach në Basel, i cili në fillim ishte një koleksion privat i cili iu shit qytetit në vitin 1661 dhe u publikua që nga viti 1671 (tani njihet si Kunstmuseum Basel). Ndër muzetë e para të artit është edhe Muzeu Britanik i Londrës i hapur më 1759, i cili njihet si muze universal ku përmban koleksione të shumta arti, si të artit të aplikuar, arkeologji, antropologji, histori e shkencë etj. Këto koleksione paraqesin artin paraeuropian dhe artin e para-Rilindjes. Njëri prej muzeve të rëndësishëm është muzeu i Luvrit në Paris (fig.6), i themeluar në vitin 1793 pas Revolucionit Francez .



Fig.6.

Pikërisht në këtë periudhë thesaret mbretërore iu shpallën njerzve dhe këtu shënohen fillat e heqjes së koleksioneve private dhe të aristokratëve dhe duke u shkrirë në sferën publike. ose thënë më qartë kjo kohë u konsiderua si një faqe për edukimin e shijes së masës dhe një finese kulturore.

Në muzetë e artit hyjnë edhe muzetë historike që mund të jenë ndërtesa të rëndësishme apo interesante, shtëpia e ndonjë njeriu të famshëm, ndërtesa që është mbajtur ndonjë mbledhje a ngjarje me rëndësi historike etj.

**Muzetë ushtarake** – zakonisht janë vendet ku janë bërë luftërat ose konfliktet e ndryshme, por mund të jenë edhe vende ku paraqiten ose ekspozohen pajisjet ushtarake të ushtarëve si: uniformat, armët, dekoratat etj. muzetë ushtarake mund të jenë ofruese të shërbimeve për ndonjë zonë të caktuar si psh. Muzeu imperial i Luftës në Duxford (fig.7) për paraqitjen e avioneve ushtarake.





fig.7

**Muzetë mobile** janë ato muze që ekspozojnë objekte të ndryshme si vetura, furgone ose qfardo lloji tjetër të automjeteve. Këto lloje të muzeve nga vet termi i tyre mund të kuptojmë që janë të lëvizshme, dhe mjetet për lëvizje shërbejnë jo vetëm për lëvizje nga vendi në vend po edhe për njëdonjë prezantim special jo të zakonshëm. Këtë mënyrë për të bërë paraqitjen e objekteve muzeologjike kryesisht për arsye arsimore e përdorë Qendra për Arte Të Ecjes.

(fig.8)



fig.8

**Muzetë historike të natyrës-** këto muze janë ato përfaqësojnë format e evolucionit të natyrës dhe biodiversitetit të mjedisit. Në këto muze ekspozohen format e qenieve parahistorike siç janë dinosauret, por gjithashtu mund të paraqiten edhe fakte antropologjike, ose të historisë më të lashtë. Të tilla muze gjinden në Londër, Oxford, Paris, Washington, New York, e në disa qendra tjera të mëdha industriale. Si shembull mund ta marrim Muzeun Historik të Natyrës në Londër (fig.9) ku ekspozohen forma të skeletëve të specieve të ndryshme që nuk ekzistojnë më.




fig.9

**Muzetë shkencore-** janë kryesisht qendra ku bëhet paraqitja e arritjeve më të reja në fushën e shkencës dhe teknologjisë. “Këto muze përdorin mediat dhe programet e tyre interaktive për të përguar shpikjet e ndërlikuara, me anë të demonstrimit të tyre”<sup>49</sup>. Shumë prej këtyre muzeve i plasojnë galeritë e tyre në internet me ç’rast shumë prej njerëzve kurioz që janë në largësi me muzetë mund ti shohin prezantimet edhe në faqe interneti.

## Roli dhe rëndësia e muzeve në turizëm

Muzetë siç shkruajtmë më lartë në një periudhë ishin themeluar për qëllime jo fitimprurëse, për arsim, edukim, ruajtje, hulumtim etj, ndërkaq me kalimin e kohës muzetë kanë ndikim më të rëndësishëm në shoqëri. Duke e parë potencialin e vlerave shumë institucione të ndryshme përdorin muzetë si partnerë kyq për tërheqjen dhe nxitjen e turistëve. Me këtë rol i muzeve është rritur në veçanti në shek. XXI. Qytetet e ndryshme botërore kanë një lloj konkurrence mes vete se cili po tërheqë vizitorë më shumë, e gjithë kjo për të shërbyer fitimit në ekonomi. Muzetë përçojnë tek turistët një tërheqje, sidomos nga sektori i kulturës duke ndikuar kështu direkt në zhvillimin e industrisë së turizmit. Mirëpo nuk është vetëm kultura ajo që i prinë pëlqyeshmërisë së vizitorëve, janë një tërësi e aktiviteteve si festivalet e ndryshme çfrardo qofshin ato tradicionale ose moderne, vende dhe hapsira për kohe të lirë dhe rekreacion, etj.

Muzetë si institucione kulturore, janë bërë katalizator të zhvillimit të qyteteve dhe rritjes së ekonomive lokale.<sup>50</sup> Edhe pse muzetë sjellin përfitime ato prapë kërkojnë mbështetje dhe publikut dhe gjithsesi edhe të organeve qeverisëse qoftë lokale ose qendrore. Për menaxhimin e mirë të muzeve lypsen profesionistë adekuat, ngase është shumë me rëndësi menaxhimi dhe organizimi i mirëfilltë i punës në muze, por edhe i fitimeve që dalin nga puna e muzeut. Disa qytete si pikëmbështetje në zhvillimin ekonomik i kanë një


<sup>49</sup> <http://en.wikipedia.org/wiki/Museum>

<sup>50</sup> [http://www.intercom.museum/conferences/2008/papers/chiehching\\_tien.doc](http://www.intercom.museum/conferences/2008/papers/chiehching_tien.doc)




pjesë të mirë të të ardhurave nga muzetë, p.sh Londrën, tre nga dhjetë vizitor e vizitojnë për muzetë e saj. Sigurisht që sa më të njoftuar dhe më të arsimuar të jenë turistët shpenzimet e tyre do të jenë më të mëdha, ngase përveç vizitës në muze ata do të konsumojnë edhe ushqimin, pijet dhe akomodimin. Pra në këtë rast kemi para shtesë që ndikojnë në rritjen e ekonomisë së zonës, dhe me këtë mund ta bëjmë një ndarje logjike të shpenzimeve me ç'rast ato që shpenzohen për muze mund të maten më lehtë, ndërsa parat e shpenzuara jashtë muzeve është më vështirë të maten ndërkaq ato para ndikojnë indirekt në zhvillimin e ekonomisë lokale.

Rol të rëndësishëm në zhvillimin e turizmit luajnë edhe muzetë superstar ose muzetë super-ye, të cilat poashtu kanë ndikim ekonomik në qytetet përkatëse. Disa prej këtyre muzeve janë si:



Pallati Kombëtar në Taipei,



Muzeu Guggenheim në Bilbao,



Galeria Tate në Londër



Muzetë Kartier në Vjenë.

Këto muze kanë luajtur një rol të madh në rigjenerimin e qyteteve të tyre përkatëse, duke ndikuar jo vetëm mbi kulturën por edhe politikën, shoqërinë, ekonominë dhe mjedisin. Muzeumet superstar janë të mëdha dhe ato përfaqësojnë një burim të pasur për turizëm; këto muze mund të kontribuojnë ndjeshëm në ekonominë e një qyteti<sup>51</sup> në njëfarë mënyre këto muze mund ta kenë potencialin kryesor ekonomik

## Disa mendime për muzetë

“Një muze duhet të ripërtrijë koleksionin e tij për të qenë gjallë, por kjo s’do të thotë që tu japim më rëndësi punëve të vjetra.- **David Rockefeller**

Një pikurë në një muze dëgjon mendimet më qesharake se qdo gjë tjetër në botë.  
- **Edmond de Goncourt**

Një libër arti është një muze pa mure.- **Andre Malraux**

Më jepni një muze dhe unë do ta plotësoj atë.-**Pablo Picasso**

<sup>51</sup> [http://www.intercom.museum/conferences/2008/papers/chiehching\\_tien.doc](http://www.intercom.museum/conferences/2008/papers/chiehching_tien.doc)



---

Unë i kam borgj muzeut; vendit më të mirë për mua, për të bërë qka unë doja të bëja .

- **George Gaylord Simpson**

Nëse shkon deri tek Gjykata Supreme, unë do të kem nën drejtim çdo muze të vendit, si dëshmi eksperte se puna ime është art legjitim. - **Jock Sturges**

Muzetë janë varre, dhe si duket gjithçka është kthyer në muze. - **Robert Smithson**

Muzeu përhap sipërfaqet e tij kudo, dhe bëhet një koleksion pa emër i përgjithësisë që mobilizon syrin.- **Robert Smithson**

Roli i një muzeu modern është që të bëjë një përzgjedhje të mirë dhe të identifikojë se çfarë ne besojmë që të jenë lëvizjet e ardhshme, dhe që kërkojnë shije.- **David Rockefeller**

Vizita në një muze nuk është tjetër pos shkuarja prej pavlefshmërisë në pavlefshmëri. -**Robert Smithson**<sup>52</sup>

---

<sup>52</sup> <http://www.brainyquote.com/quotes/keywords/museum.html>





## Përfundim

Në këtë punim seminarik u mundova të paraqes sadopak njohuri për muzetë , dhe njëkohësisht me rolin dhe rëndësin e tyre në industrinë e turizmit.

Fillimisht erdha në përfundim se muzetë janë ato vende në të cilat ruhen faktet e ngjarjeve historike, jetës së njerëzve, prej instrumenteve dhe objekteve që paraqesin lashtësin e deri tek objektet ose risitë teknologjike bashkëkohore. Por gjithashtu muzetë kanë rol themelor gjithashtu edhe në mbedhjen dhe gjetjen e objekteve të ndryshme me rëndësi qoftë historike, artistike, ose të qfardo rëndësie tjetër që mund të nxisin dhe tërheqin vizitorë dhe turistë, për ti shuar etjet e tyre për art, kulturë, dije, histori, kureshtje etj.

Qështje tjetër me rëndësi është se muzetë kanë ndikim të veçant në zhvillimin e industries së turizmit. Varësisht prej vlerave që paraqesin muzetë mund të bëjnë prurje të dobishme të të ardhurave dhe një ngritje të ekonomisë së vendit përkatës.

Shpresoj se kam mundur të paraqes thelbin e asaj që jam munduar të paraqes , ngase muzetë si intitucione kulturore kanë rëndësi shumë më të madhe sesa shihen sipërfaqësisht.

## Literatura

[www.brainyquote.com](http://www.brainyquote.com)  
[www.heritance.org](http://www.heritance.org)  
[www.icom.museum](http://www.icom.museum)  
[www.intercom.museum](http://www.intercom.museum)  
[www.wikipedia.org](http://www.wikipedia.org)



## **Nastret HASANI**

### **Vendet turistike të Kosovës**

#### **Hyrje**

Fillova ta punoj këtë punim duke parë të arsyeshëm faktin se Kosova ka mjaft zona dhe vende strategjike për zhvillimin e turizmit. Mirëpo me gjithë pasurit e saj te rralla si ato natyrore, kulturore, etnike, etj, zhvillimi, ruajtja, ose shfrytëzimi i këtyre bukurive nuk ka ende nivelin e duhur. Kosova gjendet në qendër të pjesës perëndimore të Gadishullit Ballkanik, me një formë mjaft interesante, ku rrethohet nga malet e larta të cilat janë si kufij natyror, ndërsa në brendi me fusha e lugina. Është mjaft e pasur me ujra sipërfaqësore dhe nëntokësore, ndërsa klima ndryshon varësisht nga format e relievit të cilat në këtë trevë janë të llojllojshme. Bukuritë e saj nuk kanë fund, Kosova poashtu ka një larmi te bimëve e poashtu dhe shtazëve.

Kjo trevë ka edhe një histori të veçant duke i përballuar shumë luftëra dhe ngjarje të rëndësishme, ka rajone dhe objekte të cilat tregojnë lashtësinë e kësaj toke dardane, e gjithashtu shumë monumente kulturore-historike që datojnë nga periudha ilire.

Gati në të gjitha rajonet e saj, Kosova ka kapacitete të mëdha për zhvillimin e turizmit, me një përparësi të veçant në zhvillimin e turizmit natyror, kulturor, dimëror, aventuristik, shëndetësor, tranzit etj.

Dallohen disa rajone turistike, si rajoni turistik i Mitrovicës, i Sharrit, i Prishtinës, i Anamoravës të cilat ngërthejnë në vete disa nënrajone tjera të rëndësishme. Metodologjia ime e punës, kryesisht ka qenë punë hulumtuese me anë të burimeve të internetit.

#### **Bukuritë natyrore dhe kulturore të rajonit të Mitrovicës**

Mitrovica me rrethinën e saj përbëjnë një pjesë mjaft të rëndësishme për zhvillimin e turizmit në Kosovë. Duke u nisur nga historiku i kësaj zone, mund të përmendim Nekropolin ilir vend i rëndësishëm ky, që paraqet autoktoninë shqipëtare, si pasardhës të ilirëve.

Buzë qytetit rrjedhin dy lumenj Ibri dhe Sitnica. Lumi Ibër Buron në Alpet Shqipëtare, në Kosovë hyn në vendbanimin Banjë, dhe vazhdon rrjedhën në drejtim të juglindjes së Mitrovicës. Derdhet në Danub dhe Detin e Zi. Ka karakteristikat e një lumi malor me rrjedhje të shpejtë dhe shtrat të thellë. Ka mundësinë e zhvillimit të peshkimit ngase rriten peshq ndër me të veqant peshku trofta.



## ***Ura e lumit Ibër***

Mitrovica njihet edhe si vendlindje e shumë atdhetarëve të shquar, vlen të veçohet Isa Boletini. Isa Boletini (1864- 1916), atdhetar i shquar, strateg popullor, organizator e udhëheqës i lëvizjeve për çlirim e bashkim kombëtar, Hero i Popullit. Ai lindi në fshatin Boletin. Kulla e tij është pikërisht në fshatin e tij të lindjes, ajo përbëhej prej dy kullave, kulla e burrave u ndërtua në vitin 1887 nga babai i tij ndërsa u rrënua me 1899, ndërsa kulla e grave apo “kulla e zjarrit” u ndërtua në vitin 1912. Kjo kullë u dëmtua gjatë luftës së fundit, mirëpo u ristaurua në vitin 2004.



Kulla e Isa Boletinit

## ***Kulla e Isa Boletinit***

Hamamet si simbole mijëvjeçare kanë rol të rëndësishëm në paraqitjen e trashëgimisë kulturore dhe artistike, ndër këto hamame veçojmë Hamamin e Mitrovicës që gjendet në kuadër të Muzeut të qytetit.

Shala e Bajgorës gjithashtu përbën një thesar të vërtet me karakteristika natyrore, si dhe me rezerva industriale të mëdha (plumb, zink, argjen), të cilat punohen në Trepçë.





Kristalet e Trepçës (bukuri të rralla natyrore)

### ***Kristal i Minierës së Trepçës***

Në Shalën e Bajgorës janë premiset shumë të mëdha për zhvillimin e turizmit dimëror, ngase ka një reliev dhe klimë mjaft të përshtatshme për të skijuar dhe shijuar bukuritë e rralla natyrore.



### ***Shala e Bajgorës***

Ura e Vjeter e Gurit në Vushtri është njëra ndër objektet e vjetra që përfaqëson trashëgimin kulturo-historike në periudhën ilire ngase konstatohet si urë ilire.



INSTITUTI PËR STUDIME I SHKENCAVE ORGANIZATIVE-APLIKATIVE - PRISHTINË

# PJETËR BUDI

INSTITUTE FOR STUDIES OF THE ORGANIZATIONAL AND APPLIED SCIENCES - PRISHTINA



***Ura e Gurit, Vushtrri***

Në këtë rajon poashtu shtrihet edhe Drenica, një vend historik që dha kontribut shumë të çmuar për lirinë dhe çlirimin e këtij vendi. Rol shumë të rëndësishëm në historinë më të re të popullit shqipëtar zë edhe Familja e Jasharajve e cila u masakrua nga forcat serbe, e cila dha një komandat legjendar si Adem Jashari, hero i kombit i cili luftoi deri në fund për çlirimin nga okupatori serb. Ai së bashku me 37 anëtar të asaj familje u vranë mizorisht. Kulla e Jasharajve simbolizon një ngjarje dhe një periudhë mjaftë domethënëse të historisë më të rë të Kosovës. Kjo kullë gjendet në fshatin Prekaz të Komunës së Skenderajt.



***Kompleksi i Familjes Jasharaj***



## Rajoni turistik i Prishtinës

Parku nacional i Gërmisë është ndër zonat më strategjike për zhvillimin e turizmit në rajonin e Prishtinës. *“Masivi malor i Gërmisë ka lartësi mbidetare nga 663 gjer 1050 metra, temperaturë mesatare vjetore 9,8 gradë celsius, vegjetacioni të dendur paraqet një shkallë të lartë të biodiversitetit me mbi 610 lloje të florës vaskulare dhe 32 lloje shpendësh e 19 lloje xhitarësh nga spektri i gjerë i faunës, etj.”*<sup>53</sup>.



***Parku i Gërmisë***

Shpella e Gadimes është ndër shpellat e vetme turistike të zbuluara në Kosovë, kjo shpellë gjendet në fshatin Gadime të Ulët të Lipjanit, e zbuluar rastësisht në vitin 1969 nga Ahmet Diti. Thuhet se është e gjatë rreth 1500 metra, ndërsa për publikun lejohen të shiqohen vetëm 800 metrat e para të saj. Karakteristikat kryesore që e bëjnë këtë shpellë të rëndësishme janë kristalet aragonite, shkëmbinjtë e mermerit, dhe minerale të tjera që nuk janë të pakta.



***Shpella e Mermertë e Gadimes***

<sup>53</sup> <http://www.pgjk.org/koalicioni2005.htm>



Liçeni i Batllavës është liçe artificial i ndërtuar në vitet e 70-ta, në fshatin Batllavë të komunës së Podujevës. Pas rëndësisë së madhe që ka për furnizim me ujë të pijshëm për komunën e Podujevës dhe Prishtinës njëkohësisht është mundësi mjaft stimuluese për zhvillimin e turizmit veror , të peshkimit, etj.



*Liçeni i Batllavës*

## **Zona turistike e Alpeve shqiptare**

Njëra ndër pjesët më të bukura jo vetëm të Alpeve Shqiptare po e gjithë rajonit të Kosovës është Gryka e Rugovës që paraqet një bukuri të rralle natyrore. Kjo zonë pitoreske gjendet në Bjeshkët e Nemuna të cilat janë mjaft të pasura si llojllojshmëri të florës, faunës etj., kjo pjesë dallohet edhe për lumenjtë glacial që janë pasoj e akllnajave. Në këtë zonë dallohen edhe majat më të lartra mbi 2000 metra ndër to maja më e lartë e Kosovës, maja e Gjeravicës (2656metra). Këto bjeshkë dallohen me një peisazh shumë karakteristik me mundësi të zhvillimit të turizmit dimëror.





***Bjeshkët e Rugovës***

Rajoni i Mirushës-përbën një nga pjesët më të bukura të Kosovës, ku gjenden ujëvara shumë interesante të rrjedhës së lumit të mirushës. Ujvara me lartë është në lartësinë 21metra. Lumi që rrjedh. *“Lumi Mirusha është një ndër lumenjtë më të bukur të Kosovës. Ai në pjesën përfundimtare të rrjedhës së tij kalon nëpër një grykë e cila njihet si Kanioni i lumit Mirushë.*

Parku natyror i Mirushës gjendet në të dy anët e rrjedhës së lumit Mirusha që nga fillimi i kanionit deri gati në derdhjen e tij në lumin Drini i Bardhë. Ndodhet në territorin e komunave Klinë, Malishevë dhe Rahovec. Nga Prishtina është larg 65 km.”<sup>54</sup>



***Ujvara e Mirushës.***

<sup>54</sup> <http://www.nasergashi.com/trojet-shqiptare-dhe-bukurite-natyrore-f19/mirusha-t1627.htm>



## Rajoni turistik i Sharrit

Malet e Sharrit janë përfaqësuesit me llojllojshmëri të begatshme të pasurive të ndryshme botanik, turistike, ekologjike, rekreative, edukuese, kulturore etj. një pjesë e këtyre maleve është e brojtur me ligj dhe shquhet si Park Kombëtar që nga viti 1986.

“Në përbërjen gjeologjike të Sharrit marrin pjesë shkëmbinjtë e periudhës paleozoike, shkëmbinjtë gëlqeror, të mermertë etj.”<sup>55</sup> Malet e Sharrit përbëjnë një pasri të florës dhe faunës , dhe një ndër përfaqësuesit faunës së kësaj zone është Qeni i Sharri që është karakteristik vetëm për këtë trevë.

Maja më e lartë e këtyre maleve është maja e Lubotenit 2553 metra, “mendohet se emrin e ka me origjinën frenge, "Pamje e bukur" "le bo ten"<sup>56</sup> “Është karakteristike se përbërja gjeologjike e tij është kryesisht gëlqeror, që dallohet nga malet tjera zinxhirore me përbërje gjeologjike nga silikati. Deri tani janë konstatuar 649 lloje të bimëve vaskulare të grupuara në 81 familje dhe 21 asociacione bimore. Në kuadër të florës së Lubotenit gjenden edhe lloje të rralla dhe të kërcënuara”<sup>57</sup>



**Malet e Sharrit**

Bifurkacioni i Lumit Nerodimë-është njëri ndër rastet e vetme në botë për ndarjen e lumit në dysh dhe derdhjen e tij në dy detra, lumi I Nerodimes buron në Bjeshkëte Jezercës, që fomohet prej dy degëve që bashkohen në fshatin Nerodime dhe vazhdon deri tek penda dhe aty edhe bëhet ndarja e rrjedhës së lumit “Bifurkacioni i Lumit Nerodime ndahet pakthyeshem në dy degë, të cilat kanë derdhje në dy dete të ndryshme. Dega veriore (dega e majtë) derdhët në lumin Sitnicë dhe

<sup>55</sup> <http://www.nasergashi.com/trojet-shqiptare-dhe-bukurite-natyrore-f19/malet-e-sharrit-t1630.htm>

<sup>56</sup> [http://sq.wikipedia.org/wiki/Malet\\_e\\_Sharrit](http://sq.wikipedia.org/wiki/Malet_e_Sharrit)

<sup>57</sup> <http://www.nasergashi.com/trojet-shqiptare-dhe-bukurite-natyrore-f19/malet-e-sharrit-t1630.htm>



---

vazhdon rrugëtimin në lumin Ibër, Moravë dhe përmes Danubit derdhet në Detin e Zi, ndërsa dega jugore (dega e djathtë) së pari bashkohet me njëren degë të lumit Nerodime e cila ndahet tek penda e betonit (një distancë 1300 m) dhe së bashku vazhdojnë rrugëtimin në lumin Lepenc dhe përmes Vardarit derdhet në Detin Egje.”<sup>58</sup>



***Lumi i Nerodimes***

Brezovica- është qendra më e njohur turistike e Kosovës ku është i zhvillur turizmi dimëror, mirëpo ka ende mundësi dhe kapacitete të që nuk janë shfrytëzuar ende. Në këtë rajon janë të vendosura shtigje të skijimit, me gjatësi prej 12 kilometrash, kjo qendër turistike është e hapur për skijim gati në të gjitha stinët e vitit.

---

<sup>58</sup> <http://www.nasergashi.com/trojet-shqiptare-dhe-bukurite-natyrore-f19/bifurkacioni-i-lumit-nerodime-t1628.htm>





### **Brezovica**

Komuna e Prizrenit- është qyteti i kulturës dhe traditë, ndër qytetet më të vjetra në Kosovë. *“Ka qenë edhe Kryeqytet i Shqipërisë – me panoramën e maleve të Sharrit dhe me lagjet e tij historike, të dëmtuara nga lufta por ende plotë gjallëri, me një kurorë gërmadhash të Kalasë së vjetër otomane, një fortesë strategjike kjo që daton që nga koha e ilirëve - ky qytet me shtëpitë e tij që ngjiten në kodër dhe në të njëjtën kohë integrohen në mënyrë harmonike me lumin, në të cilin të çojnë një numër i madh rrugësh me restorante dhe të vizituara në mënyrë të dendur - ky gurthemel i identitetit shqiptar dhe kosovar është një atraksion turistik gjatë tërë ditës.”*<sup>59</sup> Ky qytet me vite ka kultivuar vlea të mirëfillta origjinale. Mirëpo njihet gjithashtu me një laramani kulturash jo vetëm shqiptare por edhe të popujve tjetër që jetonin këtu. Njihet gjithashtu edhe si qyteti I “Lidhjes shqiptare” të vitit 1878, dhe si trashëgimi të kësaj ka edhe shtëpinë ku u mbajt mbledhja e udhëheqësve shqiptar për çlirimin e Shqipërisë. Njëkohësisht ky është edhe vendi më i vizituar në Prizren edhe pse u dogjë gjatë luftës së fundit de humbi shumë objekte dhe fakte, ndërkaq ato janë kopjuar dhe janë ekspozuar. Në kuadër të turizmit historik poashtu zhvillohet edhe ai kulturor, e si dëshmi kësaj janë mbajtja e disa festivaleve të rëndësishme si: Festivali i këngës së vjetër qytetare-Zambaku I Prizrenit, dhe Festivali ndërkombëtar i filmave dokumentar “Doku-Fest”.

*“ Krenaria e banorëve të Prizrenit për qytetin e tyre të mrekullueshëm do të ishte me siguri një garanci për realizimin e detyrave të rënda qytetare si: krijimi vetëdijes dhe ndërgjegjes për turizmin lokal, sigurimi i mikëpritjes dhe shërbimeve për vizitorët dhe kujdesi për pjesët e famshme dhe panoramat e Prizrenit.”*<sup>60</sup>

<sup>59</sup> [http://www.komunat-ks.net/dokumentat/20090225\\_141450\\_1.pdf](http://www.komunat-ks.net/dokumentat/20090225_141450_1.pdf)

<sup>60</sup> [http://www.komunat-ks.net/dokumentat/20090225\\_141450\\_1.pdf](http://www.komunat-ks.net/dokumentat/20090225_141450_1.pdf)





INSTITUTI PËR STUDIME I SHKENCAVE ORGANIZATIVE-APLIKATIVE - PRISHTINË

**PJETËR BUDI**

INSTITUTE FOR STUDIES OF THE ORGANIZATIONAL AND APPLIED SCIENCES - PRISHTINA



*Qyteti i Prizrenit*



---

## Përfundim

Kosova është një nga vendet e Ballkanit që ka mundësi të zhvillimit të turizmit, kjo trevë posedon shumë vlera dhe karakteristika të veçanta që e nivelizojnë si vend atraktiv, kulturor, historik, artistik e tjera epitete që i veshen pasurive të çmueshme që posedon.

Sipas asaj qka pata mundësin të hulumtoj erdha në konkluzion se Kosova nuk i shfrytëzon aq sa duhet dhe sa ka mundësi këto begati mjaft të vlefshme, e sidomos ato natyrore.

Tjetra është se mundësitë e zhvillimit të turizmit në Kosovë veçohen nëpër disa zona gjegjëse, si ajo e Mitrovicës, Prizrenit, Sharrit, Alpeve Shqipëtare etj.

Konkludoj gjithashtu se janë shumë të pakta projektet për strategjinë dhe zhvillimin e turizmit në Kosovë, andaj shpreh shumë të nevojshme përpilimin e sa më shumë projekteve për inicimin e ndërrmarjeve të udhëtimeve turistike, gjithashtu e rëndësishme do të ishte që të mbahen organizime të ndryshme për nxitjen dhe tërheqjen e vizitorëve të huaj ngase Kosova ka resurse të mjaftueshme për zhvillimin e kësaj industrie që ka pushtuar tërë botën.

## Burimet dhe literatura e shfrytëzuar

[www.wikipedia.org](http://www.wikipedia.org)

[www.kk-vushtrri.org](http://www.kk-vushtrri.org)

[www.komunat-ks.net](http://www.komunat-ks.net)


[www.kosova.org](http://www.kosova.org)

[www.pgj.org](http://www.pgj.org)

[www.telegrafi.com](http://www.telegrafi.com)

[www.trepca.net](http://www.trepca.net)

[www.visitkosova.org](http://www.visitkosova.org)



## PJETËR BUDI

INSTITUTI PËR STUDIME I SHKENCAVE ORGANIZATIVE-APLIKATIVE - PRISHTINË

INSTITUTE FOR STUDIES OF THE ORGANIZATIONAL AND APPLIED SCIENCES - PRISHTINA



Vol. 2/2010